



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Kërkesa nr. 23

Data 6.5.2023  
Nr. Prot 4736

**KËRKUES:** KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

**OBJEKTI:** Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ

**DREJTUAR:** KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar më datë 25.3.2023, në adresën email, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është dërguar raporti XIV i Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), për gjetjet dhe rekomandimet për të cilin pretendohet se janë ripostuar aktivitete të postuara në faqen zyrtare të kryetarit dhe njëkohësisht kandidatit për kryetar të bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerëson se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të procedurës administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vijoi hetimin administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Denoncuesi kërkon hetimin e rastit dhe marrjen e masave administrative për personat përgjegjës të kësaj shkelje.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Nga ana e personit përgjegjës për bashkinë Kamëz, nuk kemi administruar asnjë përgjigje.

Në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se rasti objekt denoncimi regjistruar me nr. 335 ID përbën shkelje të nenit 91, të Kodit Zgjedhor.

Referuar nenit 171, pika 1, të Kodi Zgjedhor, ku parashikohet se, *"Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë"*.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, si dhe në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, 91, 171, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, marrjen e masës administrative ndaj:

- **Z. Elvis Gjika, person përgjegjës për bashkinë Kamëz, gjobë në masën 3 000 (tre mijë) lekë.**

Nga të dhënat, rezulton se z. Elvis Gjika nuk është përsëritës për shkeljen.

Bashkëlidhur kërkesës për vendosje të sanksionit administrativ, ju vëmë në dispozicion, provat si më poshtë vijon:

- Vendimi nr. 443, datë 05.05.2023 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 347 ID, të Koalicioni për Reforma, Integrim dhe institucione të Konsoliduara, ndaj personit përgjegjës për bashkinë Kamëz, për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023;
- Denoncimi për bashkinë Kamëz, i regjistruar me nr. 347 ID, datë 25.03.2023 nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)
- Provat link në rrjetin social Facebook:



- o [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0yfALJYhn6y8jUXJmu9UiUTDgQevG4vxG1fpvU4y7UCvLVaKev3m18PXHAjLTmRUtl&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0yfALJYhn6y8jUXJmu9UiUTDgQevG4vxG1fpvU4y7UCvLVaKev3m18PXHAjLTmRUtl&id=100077339029573)
- o [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0nbDxk2jRjN9HhJCMTLrdb55AxëMyNsghJd4h1tAvUJHĒnNdjBN14DKozFgaLifel&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0nbDxk2jRjN9HhJCMTLrdb55AxëMyNsghJd4h1tAvUJHĒnNdjBN14DKozFgaLifel&id=100077339029573)
- o [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid025MXFHcn2RFee6aZMgsgpbtAuH3RoPqxZ57qhDVOëpĒVmdGMm5ëPXMëĒ1ĒRs1Ef9LI&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid025MXFHcn2RFee6aZMgsgpbtAuH3RoPqxZ57qhDVOëpĒVmdGMm5ëPXMëĒ1ĒRs1Ef9LI&id=100077339029573)
- o [https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0dUKVpĒYuDNFSjVhfu3ZQragSMs4SeBR6nYCC2CA2më6dzptiëAqYh2FPZzzj9Tëel&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0dUKVpĒYuDNFSjVhfu3ZQragSMs4SeBR6nYCC2CA2më6dzptiëAqYh2FPZzzj9Tëel&id=100077339029573)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kopje: 3  
Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:  
E. Mema  
I. Horanlliu  
M. Koja  
A. Lamçe  
Y. Merkaç

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**





Re: Kerkese per informacion, (347)

denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Thu 5/4/2023 2:28 PM

To: Rebeka Sulejmani <rebekasulejmani98@gmail.com>

Cc: info@kriik.al <info@kriik.al>

Bcc: Ylli Merkaj <Ylli.Merkaj@kqz.gov.al>; Aurel Lamce <Aurel.Lamce@kqz.gov.al>; Madalena Koja <Madalena.Koja@kqz.gov.al>

Përshëndetje,

Ju njoftojmë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, do të zhvillojë seancë publike, mbi hetimin administrativ të nisur ndaj Institucionit Tuaj.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", ju keni të drejtën të paraqiteni vetë ose me mbrojtës ligjor për të dhënë shpjegimet tuaja, ditën e premte, më datë 5 Maj 2023, ora 12:30, në adresë Rr. "Ibrahim Rugova", nr. 4, Tiranë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

---

From: denoncime

Sent: Wednesday, April 26, 2023 8:22 PM

To: Rebeka Sulejmani <rebekasulejmani98@gmail.com>

Cc: info@kriik.al <info@kriik.al>

Subject: Kerkese per informacion, (347)

Pershendetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më datë 25.03.2023, në adresën e e-mail-it, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është dërguar raporti XIV i Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), për gjetjet dhe rekomandimet. Njëpërmjet këtij raporti, është administruar denoncimi për Institucionin Tuaj, njëpërmjet të cilit pretendohet si më poshtë vijon:

*"Bashkia Kamëz, vijon ende me postimet në faqen zyrtare Facebook të Bashkisë, të aktivitetit elektoral të kryetarit aktual dhe njëkohësisht kandidatit të Partisë Socialiste në këtë bashki.*

*Disa nga postimet përkatëse mund të aksesohen në linqet e mëposhtme, ndërsa në Lidhjen nr. 3 bashkëlidhur mund të gjeni foto/printscreens të postimeve në faqen e Bashkisë Kamëz:*

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0yfALJYhn6y8jUXJmu9UiUTDgQevG4vxGIjfpvU4y7UCvLVaKev3m18PXHAjLTmRUtl&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0yfALJYhn6y8jUXJmu9UiUTDgQevG4vxGIjfpvU4y7UCvLVaKev3m18PXHAjLTmRUtl&id=100077339029573) ;

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0nbDxk2jRjnD9HhJCMTLrdb55AxëMyNsghJd4h1tAvUJHËnNdjBN14DKozFgaLjfel&id=100](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0nbDxk2jRjnD9HhJCMTLrdb55AxëMyNsghJd4h1tAvUJHËnNdjBN14DKozFgaLjfel&id=100)



077339029573 ;

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid025MXFHcn2RFee6aZMgsgpbtAuH3RoPqxZ57qhDVQëpEVmdGMm5ëPXMëË1ËRs1Ef9Ll&id=100077339029573 ;](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid025MXFHcn2RFee6aZMgsgpbtAuH3RoPqxZ57qhDVQëpEVmdGMm5ëPXMëË1ËRs1Ef9Ll&id=100077339029573)

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0dUKVpËYuDNFSjVhfu3ZQragSMs4SeBR6nYCC2CA2më6dzptiëAqYh2FPZzzj9Twel&id=100077339029573 ;](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0dUKVpËYuDNFSjVhfu3ZQragSMs4SeBR6nYCC2CA2më6dzptiëAqYh2FPZzzj9Twel&id=100077339029573 ;)"

Persa më sipër, kerkojme të paraqisni pretendimet tuaja brenda 2 (dy) ditësh nga marrja e ketij e-maili.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.





**Lidhja Nr. 3: Postimet e fushatës elektorale të Partisë Socialiste në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz.**

**Bashkia e Kamëz**


**Intro**

Me 15 maj 2017 ne bashkisë së Kamëzit kemi...

- [Krye - Home](#)
- [Kontakt - Contact Us](#)
- [Waze - Waze](#)
- [Google Maps](#)


**Photos**

SHALLI DITËS



**Bashkia e Kamëz**

1 2 3 4



**Koleksi i shtet**

1 2 3 4

Me 15 maj 2017 ne bashkisë së Kamëzit kemi bashkuar me 15 kandidatë për bashki të reja dhe 15 kandidatë për bashki të vjetra.

1 2 3 4

+20





**Lidhja Nr. 3: Postimet e fushatës elektorale të Partisë Socialiste në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz.**

**Bashkia Kamëz**  
2d · 0



**Rakip Suli**  
2d · 0

#MeRakipSulit  
#VeprimiPërparim  
#KamëzMT

1 share

**Photos**

See all photos



**Photos**

See all photos

**bashkakarnez@gmail.com**  
www.kamëz.gov.al  
Closing Soon



**Lidhia Nr. 3: Postimet e fushatës elektorale të Partisë Socialiste në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz.**

[bashkakametz@gmail.com](mailto:bashkakametz@gmail.com)  
[www.kametz.gov.al](http://www.kametz.gov.al)  
 Closing Soon

Photos

See all photos

Prishtinë, Tërnisë, Administrata e PD Çirçipër, Tërnisë, Kamëz, Vite, 2023

Bashkia Kamëz

3d · 0  
**Roberto Suli**  
 Përfundim i mirëkësimit nga hapja e kufirit, me gratë dhe vajzë, ju njerëz motorrit diejt  
 14 maj, me bingjës të plotë që këtu herë Kamëz do të japë mesazhin e datur për qitë  
 Shqipërinë.

Kamëz e ka bërë zgjedhjen, ka zgjedhur shëndëtorin e saj, ka zgjedhur njeriun e punës, ka  
 zgjedhur dërrin e hapur për të qitë dhe këtë do ta dërrmojë masivisht në 14 maj.

#VetemPerpara  
 #14Maj

1 comment

15





Lidhja Nr. 3: Postimet e fushatës elektorale të Partisë Socialiste në fagen zyrtare të Bashkisë Kamëz.

**Bashkia Kamëz**

**Intro**  
Mbledhja e Mbrojtjes Zyrtare të Bashkisë Kamëz.

**Page - 1/10**

**Photos**  
Ekskursione

**Bashkia Kamëz**  
Mbledhja e Mbrojtjes Zyrtare të Bashkisë Kamëz.

**MSHARA**  
**PLISPAVA**

**Bashkia Kamëz**  
Mbledhja e Mbrojtjes Zyrtare të Bashkisë Kamëz.

**MSHARA**  
**PLISPAVA**



**Bashkia Kamëz**  
Mbledhja e Mbrojtjes Zyrtare të Bashkisë Kamëz.

**MSHARA**  
**PLISPAVA**





**Lidhja Nr. 3: Postimet e fushatës elektorale të Partisë Socialiste në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz.**












Lidhja Nr. 3: Postimet e fushatës elektorale të Partisë Socialiste në faqen zyrtare të Bashkisë Kamëz.







**Lidhja Nr. 3: Postimet e fushatës elektorale të Partisë Socialiste në fagen zyrtare të Bashkisë Kamëz.**







**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data 6.5.2023  
Nr. Prot 4735

**KËRKUES:** KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

**OBJEKTI:** Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ

**DREJTUAR:** KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë indicie për publikimin e postimeve me përmbajtje elektorale, në rrjetin social "Facebook", nga faqja faqet zyrtare të 6 (gjashtë) ministrive dhe 10 (dhjetë) ministrave, për të cilat pretendohet nga denoncuesi se postime me përmbajtje partiake në faqet zyrtare, përbëjnë përdorim të burimeve publike.

Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link dhe materialeve fotografike, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet raportit të KRIIK, të datës 24 Prill 2023, "Për gjetjet dhe rekomandimet për javën 14 Prill- 20 Prill 2023".

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerëson se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundrvajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të tyre, provohet se të gjitha postimet dhe ripostimet në faqet zyrtare të rrjetit social "Facebook", të bashkive subjekt i këtij denoncimi, janë përdorur hashtag dhe slogane me përmbajtje elektorale.

Nga verifikimet paraprake dhe provat e administruara vlerësoj se faqet e rrjetit social "Facebook", me emrin Ministrive, janë faqe zyrtare të këtyre institucioneve.



Kodi Zgjedhor në nenin 91, pika 1 parashikon se *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”*. Po ky nen parashikon se *“burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit*.

Vënia në dispozicion e faqeve zyrtare në *“facebook”* apo çdo mjete tjetër elektornik (media sociale) të institucioneve publike për publikimin e postimeve apo të ripostimeve të cilat përmbajnë hashtag #, slogane me karakter politik/elektoral në zgjedhje, apo thirrje për mbështetje në zgjedhje nga ana e këtyre institucioneve përbën përdorim të burimeve publike.

Në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se rasti shqyrtimi për pikat 3, 5, 7, 9, 11, të denoncimit të administruar përbëjnë shkelje të nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, dhe kur shkelja nuk përbën veprë penale, dënohet me gjobë nga 3000 (tre mijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, si dhe në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat *“dh”, “f” dhe “n”*, pika 2, nenet 91, 171, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, *“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”*, vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”, i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, marrjen e masës administrative në vlerën 3 000 (tre mijë) lekë ndaj:

- Zj. Ledina Agalliu, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit;
- Zj. Zerina Bruci, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës;
- Z. Ismail Shehu, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë;
- Zj. Joana Duro, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Zj. Risena Xhaja, sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

- Nga të dhënat, rezulton se z. Ledina Agalliu është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Zerina Buci nuk është përsëritës për shkeljen.



- Nga të dhënat, rezulton se z. Ismail Shehu është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Joana Duro është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Risena Xhaja është përsëritës për shkeljen.

Bashkëlidhur kërkesës për vendosje të sanksionit administrativ, ju vëmë në dispozicion, provat si më poshtë vijon:

- Vendimi nr. 442, datë 05.05.2023 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 350 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe ndaj zv. Kryeministrit, Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Ministrit të Kulturës, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrit të Shtetit për Standartet dhe Shërbimet, Ministrit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Denoncimi i regjistruar me nr. 350 ID, datë 24.02.2023 nga Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) dhe provat bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kopje: 3  
Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:  
E. Mema  
I. Horanlliu  
M. Koca  
A. Lamçe  
Y. Merkaç

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**







Soubson

Lidhia nr. 7 Postime të shoqëruara me hashtag e sloganë elektorale të Partisë Socialiste në faqet Zyrtare të Ministrive dhe Ministrave: **#TeBashkuarJetoNdarë**; **#ShqiperiaEArhimjaJone** dhe **#SkakohëPërPushim**

<https://www.facebook.com/MinistriaeFinancaveDheEkonomise>


















**Lidhja nr. 7.** Postime të shoqëruara me hashtag e sloganë elektoralë të Partisë Socialiste në faqet Zyrtare të Ministrive dhe Ministrave: **#TëBashkuarJotëNdarë**, **#ShqipëriaEardhijalënë** dhe **#SkakohëPërPushim**

5. Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Kulturës, <https://www.facebook.com/kultura.gov.al>

The screenshot shows the Facebook profile of the Ministry of Culture of Albania. The profile name is 'Ministria e Kulturës' with a verified badge. The page is set to 'Public' and has 1,000+ likes. The main content area displays a grid of posts, all titled 'KULTURA 2023'. Each post includes a cover image and a text description. The posts are arranged in a grid that scrolls horizontally. The interface includes a navigation bar at the top with options like 'Intro', 'Page', and 'Photos'. The text in the posts is partially visible, mentioning cultural events and initiatives.



**Lidhja nr. 7. Postime të shoqëruara me hashtag-e sloganë elektoralë të Partisë Socialiste në faget Zyrtare të Ministrive dhe Ministrave: **#TëBashkuarJotëNdarë**; **#ShqipëriaEArhimjaJonë** dhe **#SkakohëPërPushim****

**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**

---

**Intro**

Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Republika e Shqipërisë.

**Page** · Government organization

04 222 4537

turizmit.gov.al

---

**Photos** See all photos

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Shqipëria prezantohet në panairin më të madh të turizmit, "ITB Berlin 2023" më 7-9 marr. Jo vetëm me placet dhe prezantim të kulturës, por edhe me diversitetin e ofertës turistike, imazhin e përmirësuar të vendit dhe investimet publike e private në këtë sektor.

Në datat 3, 4 dhe 5 prill në Tiranë do të mbahet Forumi Ndërkombëtar i Turizmit, organizuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Turizmit (UNWTO).

**Mirela Kumburo Furrli**

Shqipëria në ITB Berlin: Rënjori më i madh i Turizmit në botë, ku më në fund përfaqësohemi denjësisht jo thjesht me natyrën e bukur po me një ofertë sezonizuese turistike, falë punës këmbëngulëse vit për vit, ndryshimit të imazhit të zyrës së Shqipërisë së deri disa viteve më parë, investimeve publike e private, si edhe një armate drejmtike operatorësh turistikë.

Peson në prill Forumi Ndërkombëtar i Turizmit në Tiranë, një bashkëpunim i minishisë sonë të Turizmit e Mjedisit me Organizatën Botërore të Turizmit, për të cilin besojmë në Berlin edhe me Sekretarin e Përgjithshëm #UNWTO Zurab Podelkadzevili.

#TëBashkuarJotëNdarë

#ShqipëriaEArhimjaJonë

#SkakohëPërPushim



Source

Lidhia nr. 7. Postime të shogëruara me hashtag-e sloganë elektoralë të Partisë Socialiste në faqet Zyrtare të Ministrive dhe Ministrave: #TëBashkuarJotëNdarë; #ShqipëriaEArdhmjaJonë dhe #SkakohëPërPushim

7. Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Drejtësisë, <https://www.facebook.com/drejtesia.gov.al>







## Ina Horanliu

---

**From:** Madalena Koja  
**Sent:** Monday, April 24, 2023 08:31  
**To:** Ina Horanliu; Kejsa Bici; Blerta Ereqi  
**Subject:** Fwd: KONSTATIME – Raporti XIV - Gjetje e Rekomandime për javën 14-20 prill 2023, lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve-20230422!  
**Attachments:** Lidhje\_1-KRIIK-Permbledhje\_AktiviteteteRaportuaraMeVonese--Rap XIV-20230422.pdf; Lidhje\_3-KRIIK-PostimePartiakePS\_FaqeZyrtareBashkiaKamëz--Rap XIV-20230422.pdf; Lidhje\_4-KRIIK-Fjala\_E.Veliaj\_MbledhjaEKeshillitBashkiakTirane19prill23--Rap XIV-20230422.pdf; Lidhje\_5-KRIIK-TransmetimiLIVeMedia\_MbledhjaEKeshillitBashkiakTirane19prill23--Rap XIV-20230422.pdf; Lidhje\_6-KRIIK-PostimeMeSloganeElektoralTePSneFaqetEBashkiveEKryetareve--Rap XIV-20230422.pdf; Lidhje\_7-KRIIK-PostimeMeSloganeElektoralTePSneFaqetEMinistriveEMinistrave--Rap XIV-20230422.pdf; Lidhje\_2-KRIIK-AktiviteteteRaportuaraMeVonese--Rap XIV-20230422.xlsx

Fya

[Get Outlook for Android](#)

---

**From:** Coalition for Reforms, Integration and Consolidated Institutions (KRIIK Albania) <info@kriik.al>  
**Sent:** Monday, April 24, 2023 8:00:31 AM  
**To:** Elvira Gaxholli <elvira.gaxholli@kqz.gov.al>  
**Cc:** Ilirjan Celibashi <Ilirjan.Celibashi@kqz.gov.al>; Ylli Merkaj <Ylli.Merkaj@kqz.gov.al>; Erton Sinani <Erton.Sinani@kqz.gov.al>; Majlinda Celmeta <Majlinda.Celmeta@kqz.gov.al>; Valbona Ballgjini <Valbona.Ballgjini@kqz.gov.al>; Ermina Allushi <Ermina.Allushi@kqz.gov.al>; Madalena Koja <Madalena.Koja@kqz.gov.al>; Daniela Alimemeti <Daniela.Alimemeti@kqz.gov.al>; Drilona Hoxhaj <Drilona.Hoxhaj@kqz.gov.al>; Dritan Taulla <dritan.taulla@kriik.al>; Antuela Male <antuela.male@kriik.al>; Premto Gogo <premtogogo@kriik.al>  
**Subject:** KONSTATIME – Raporti XIV - Gjetje e Rekomandime për javën 14-20 prill 2023, lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve-20230422!

**Drejtuar:** Komisionit Qendror të Zgjedhjeve  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
z. Ilirjan CELIBASHI

**Lënda\*:** **KONSTATIME – Raporti XIV i Gjetjeve dhe Rekomandimeve për javën 14-20 prill 2023, lidhur me raportimet në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së të veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore.**

**I Nderuar Z. Komisioner!**

**Të nderuar Kolegë të Administratës së KQZ-së!**

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin në vazhdimësi, mund të gjeni në vijim Gjetjet dhe Rekomandimet e Raportit të monitorimit të KRIIK për javën e katërbëdhjetë të funksionimit të mekanizmit të raportimit të institucioneve në ndërfaqe, për periudhën 14 – 20 prill 2023.





Gjatë monitorimit të kësaj jave, KRIIK ka evidentuar disa problematika, si:

1. Raportimi i aktiviteteve me vonesë
2. Raportime ku mungojnë detajet
3. Postimi i aktiviteteve elektorale në faqen zyrtare të Bashkisë
4. Propagandë elektorale në aktivitete institucionale
5. Përdorimi në postimet e aktiviteteve institucionale të hashtag-eve slogane elektorale: #TëBashkuarJoTëNdarë; #ShqipëriaEArdhmjaJonë dhe #SkaKohëPërPushim

Konkretisht:

## 1. RAPORTIMI I AKTIVITETEVE ME VONESË

Pavarësisht minimizimit, vijon ende praktika e raportimit të aktiviteteve me vonesë.

Nga monitorimi i bërë rezulton se **rreth 1.9% e raportimeve në javën e katërbëdhjetë janë me vonesë**. Specifikisht, nga 206 aktivitete të raportuara gjatë kësaj periudhe, 4 janë raportuar me vonesë (*për më shumë shih Lidhjen 1, e cila përmbledh të dhënat për raportimet me vonesë, si dhe Lidhjen 2 me listën e detajuar të këtyre aktiviteteve, së bashku me të dhënat përkatëse referuar ndërfaqes së aktiviteteve në faqen e internetit të KQZ-së*). Numri total i institucioneve raportuese përgjatë periudhës kohore që mbulon ky raport është 51, nga të cilat 4 kanë raportuar së paku një aktivitet përtej afatit të përcaktuar ligjor.

*Ritheksohet se këto shifra i referohen vetëm raportimeve të kryera nga institucionet në ndërfaqe dhe që mund të aksesohen aty.*

*Nëse në KQZ kanë mbërritur raportime me anë të postës elektronike, apo me mjete të tjera të komunikimit dhe nuk janë hedhur në ndërfaqe, këto nuk përfshihen në të dhënat e mësipërme.*

**KRIIK shpreh vlerësimin mbi disa vendimmarrje të KSHZ për ndalimin paraprakisht të aktiviteteve të raportuara me vonesë prej institucioneve, por kjo duhet të kthehet në një praktikë solide e të menjëhershme të administratës së KQZ-së për të ndaluar çdo aktivitet sapo ai të hidhet në ndërfaqen e raportimit dhe konstatohet se është raportuar jashtë afatit.**

Ky qëndrim është në linjë me rekomandimet që KRIIK ka bërë në vazhdimësi në raportet e mëparshme.

Gjithashtu, KRIIK risjell në vëmendje se **ende mbeten relevante Rekomandimet konkrete**, qoftë në nivel politik e të përgjithshëm, qoftë në nivel teknik e konkret, të **përcjella** nëpërmjet Raporteve të mëparshme të Monitorimit, e veçanërisht atyre të tre javëve të para.

## 2. RAPORTIME KU MUNGOJNË DETAJET

Vërehet se vijon mungesa e detajeve në një numër raportimesh, detaje të cilat do të bënin të mundur që monitoruesit e KQZ-së apo të tjerë aktorë të interesuar të mund të marrin pjesë apo t'i vëzhgojnë eventet.

**Gjithashtu, sikurse është konstatuar edhe nga ju si administratë, mungesa e detajeve sjell një problematikë serioze në monitorimin e aktiviteteve, veçanërisht për evidentimin e aktiviteteve të raportuara. Aktivitetet e raportuara pa detaje pamundësojnë identifikimin e tyre, pasi nuk është e mundur të përcaktohet konkretisht aktiviteti.**





Të tilla raste janë të shumta, por sillen si shembuj ilustrues vetëm dy prej tyre:

- “Java boterore e vaksinimit -Fushata HPV” për të cilin tek fusha “**Vendi i Zhvillimit**” plotësohet “**Tiranë**”, Linku i raportimit: <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/04/20/java-boterore-e-vaksinimit-fushata-hpv/>.
- “Mbjellje pemesh me gjimnazistet” për të cilin tek fusha “**Vendi i Zhvillimit**” plotësohet “**Tiranë**”. Linku i raportimit: <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/04/20/mbjellje-pemesh-me-gjimnazistet/>.

Po ashtu, në raportimet e Bashkisë Tiranë nuk jepet emri i personit përgjegjës, por veçse emri i pozicionit, edhe ai i paspecifikuar. Konkretisht: “Personi përgjegjës për raportim: Drejtor i Pergjithshem”; - “Personi i ngarkuar nga ligji për raportim (Sekretari i Përgjithshëm/drejtori përgjithshëm/drejtuesi më i lartë administrativ): Drejtor i Pergjithshem”.

**Në vazhdimësi të sa është kërkuar në raportet e mëparshme, është me vend që KQZ t’u tërheqë vëmendjen institucioneve raportuese në lidhje me këtë fenomen, pasi kjo mënyrë raportimi përbën së paku mos përbushje në mënyrën e duhur të detyrimit ligjor.**

### **3. POSTIMI I AKTIVITETEVE ELEKTORALE NË FAQEN ZYRTARE TË BASHKISË**

Faqet zyrtare në rrjetet sociale, të institucioneve dhe drejtuesve të tyre, kanë të njëjtën rëndësi dhe duhet t’i nënshtrohen të njëjtave rregullave sikurse faqet zyrtare të internetit të tyre.

Madje, duke konsideruar audiencën shumë herë më të lartë të tyre dhe përdorimin e gjerë nga njerëzit, institucionet dhe drejtuesit e tyre kanë një fokus disa herë më të madh në këto platforma komunikimi sesa në ato tradicionale.

Në vazhden e monitorimit të tyre përgjatë periudhës parazgjedhore, KRIIK, përpos të tjerave, ka identifikuar dhe **ju ka përcjellë pesë raste ku në Faqet Zyrtare të disa Bashkive në Facebook**, postohen apo shpërndahen njoftime mbi aktivitete partiake, e konkretisht të Partisë Socialiste të Shqipërisë (Raporti i javës së 9-të të monitorimit). Konkretisht, në të përfshiheshin Bashkitë Poliçan, Kamëz, Kurbin, Konispol, Memaliaj.

Ndërkohë që për tre nga bashkitë e sipërpërmendura KQZ ka marrë vendim dhe pushuar hetimin administrativ (vendimi nr. 266 datë 05.04.2023), për dy prej tyre, konkretisht Bashkia Kamëz dhe Bashkia Poliçan, nuk ka ende vendimmarrje.

KRIIK ka vijuar monitorimin e këtyre faqeve, dhe **konstaton se Bashkia Kamëz, vijon ende me postimet në faqen zyrtare Facebook të Bashkisë**, të aktivitetit elektoral të kryetarit aktual dhe njëkohësisht kandidatit të Partisë Socialiste në këtë bashki.

Disa nga postimet përkatëse mund të aksesohen në linqet e mëposhtme, ndërsa në *Lidhjen nr. 3* bashkëlidhur mund të gjeni foto/printscreens të postimeve në faqen e Bashkisë Kamëz:

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0yfALJYhn6y8jUXJmu9UiUTDgQevG4vxG1fpvU4y7UCvLVaKev3m18PXHAjLTmRUtl&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0yfALJYhn6y8jUXJmu9UiUTDgQevG4vxG1fpvU4y7UCvLVaKev3m18PXHAjLTmRUtl&id=100077339029573) ;

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0nbDxk2jRjD9HhJCMTLrdb55AxëMyNsghJd4h1tAvUJHëNndjBN14DKozFgaLjfel&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0nbDxk2jRjD9HhJCMTLrdb55AxëMyNsghJd4h1tAvUJHëNndjBN14DKozFgaLjfel&id=100077339029573) ;

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid025MXFHcn2RFee6aZMgsgpbtAuH3RoPqxZ57qhDVQëpËVmdGMm5ëPXMëË1ËRs1Ef9Ll&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid025MXFHcn2RFee6aZMgsgpbtAuH3RoPqxZ57qhDVQëpËVmdGMm5ëPXMëË1ËRs1Ef9Ll&id=100077339029573) ;





[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0dUKVpEYuDnFSjVhfu3ZQragSMs4SeBR6nYC2CA2më6dzptiëAqYh2FPZzzj9TweI&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0dUKVpEYuDnFSjVhfu3ZQragSMs4SeBR6nYC2CA2më6dzptiëAqYh2FPZzzj9TweI&id=100077339029573) ;

Në gjykimin e KRIIK, këto postime me përmbajtje partiake në Faqen Zyrtare të Bashkisë, sikurse ju është bërë me dije edhe më parë, përbëjnë haptazi shpërdorim të burimeve dhe autoritetit të institucionit në funksion të partisë politike, e konkretisht të subjektit zgjedhor Partia Socialiste.

**KRIIK nxit KQZ-në t'i marrë në konsideratë këto denoncime e procedojë sipas parashikimeve ligjore për të sanksionuar jo vetëm institucionin, por edhe Kryetarët e Bashkive si dhe subjektin zgjedhor Partia Socialiste,** sipas nenit 172 pika të Kodit Zgjedhor, pasi në favor të kësaj të fundit janë kryer shkeljet e mësipërme.

KQZ-ja nuk duhet në asnjë rast të tregohet tolerante në rastet e moskthimit përgjigje prej institucioneve sikurse ka ndodhur në disa prej hetimeve administrative të zhvilluara, por duhet t'i konsiderojë këto raste si mosbashkëpunim me të duke vepruar sipas Neni 169 "Mosbashkëpunimi me KQZ-në" të Kodit Zgjedhor.

#### 4. PROPAGANDË ELEKTORALE NË AKTIVITETE INSTITUCIONALE

Në vijim të monitorimit, KRIIK ka evidentuar në **mbledhjen e datës 19 prill 2023 të Këshillit Bashkiak të Tiranës shkelje që përbëjnë përdorim të burimeve shtetërore për avantazh elektoral** nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj.

Paraprakisht, rikthejmë në vëmendjen tuaj se përdorimi i burimeve zyrtare në fushatë për avantazh elektoral nuk konsiston vetëm në përdorimin e burimeve me efekt financiar apo atyre njerëzore, por shumë më tepër se kaq.

Në frymën e ndarjes së partisë nga shteti,<sup>[1]</sup> OSBE/ODIHR e përkufizon përdorimin e burimeve shtetërore si "...avantazh i padrejtë nga disa parti ose kandidatë, nëpërmjet përdorimit të pozitave të tyre zyrtare ose lidhjeve me institucionet qeveritare, për të ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve"<sup>[2]</sup>.

Konkretisht, fjala e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj, gjatë mbledhjes së Këshillit Bashkiak të 19 prillit 2023, në gjykimin e KRIIK është një fjalë me natyrë të pastër elektorale.

Përgjatë gjithë fjalimit, z. Veliaj ka bërë një numër komentesh me natyrë të qartë elektorale, duke komentuar negativisht subjekte zgjedhore konkurrenente në këto zgjedhje (konkretisht në lidhje me Koalicionin "Bashkë Fitojmë"), duke komentuar elementë të programit elektoral të kandidatit për Kryetar Bashkie të po këtij Koalicioni, madje edhe duke u shprehur në lidhje me pritshmëritë e rezultatit zgjedhor në favor të tij.

Për më tepër, në një numër të komenteve të kryera është përdorur një gjuhë denigruese si dhe sulme personale. Për më shumë në lidhje me komentet specifike, shih bashkëlidhur në Lidhjen nr. 4, transkriptin e fjalës së z. Veliaj gjatë Mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 19 prill 2023, ku disa prej elementëve më të dukshëm janë të markuara ne shkrim të errët.

Theksohet se, mbledhjet e Këshillit Bashkiak të Tiranës janë **mbledhje të institucionit të Bashkisë së Tiranës dhe z. Veliaj ishte në këtë mbledhje në funksionin e tij institucional si Kryetar i Bashkisë, dhe jo si kandidat.** Pra komentet e kryera në këtë mbledhje përbëjnë përdorim të një eventi institucional për fushatë elektorale.

Për më tepër, mbledhja e djeshme e Këshillit Bashkiak ishte një mbledhje e transmetuar gjerësisht në media. Përveçse e transmetuar në kohë reale në faqen e Bashkisë Tiranë në Facebook (çka përbën edhe një tjetër mënyrë se si burimet institucionale janë përdorur për efekte fushate) apo të tjera faqe në rrjete sociale, ajo është





transmetuar po në kohë reale nga së paku 5 televizione (shih Lidhjen Nr. 5, foto/screenshots nga mediat që kanë transmetuar në kohë reale Mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës 19 prill 2023).

Gjithë sa më sipër bëhet akoma më problematike nëse konsiderojmë se tanimë jemi në fazën më intensive të takimeve të kandidatëve me elektoratin, atë të fushatës zgjedhore.

**Kryetari i Bashkisë Tiranë e përdori mbledhjen e djeshme të Këshillit Bashkiak dhe pozicionin e tij zyrtar si Kyebashkiak për të përfituar një avantazh elektoral ndaj konkurrentëve të vet në garë, duke dëmtuar në këtë mënyrë barazinë në garë, në shkelje të parimeve për zgjedhje të ndershme dhe demokratike, përveçse në shkelje të Kodit Zgjedhor dhe të Vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator.**

Përpos sa më sipër, KRIIK gjithashtu sjell në vëmendjen tuaj se natyra e vendimeve të djeshme të Këshillit Bashkiak është e tillë që qartas përbëjnë vendime me efekt elektoral, për të cilat KQZ-ja duhet të investohet për të mbajtur qëndrimin e duhur që ligji i ngarkon.

Bazuar në sa më sipër, KRIIK i bën thirrje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të veprojë sipas parashikimeve ligjore në fuqi, duke sanksionuar Kryetarin e Bashkisë Tiranë për përdorimin e një aktiviteti institucional për qëllime elektorale.

Në linjë edhe me denoncimet e mëparshme të sjella, KRIIK gjithashtu rithekson se përbën domosdoshmëri që KQZ-ja të vërë para përgjegjësisë ligjore gjithashtu Subjektin Zgjedhor Partia Socialiste, në avantazh të të cilit është kryer shkelja, në përputhje me pikën 1 të nenit 172 të Kodit Zgjedhor.

## **5. PËRDORIMI NË POSTIMET E AKTIVITETEVE INSTITUCIONALE TË HASHTAG-EVE SLOGANE ELEKTORALE: #TËBASHKUARJOTËNDARË; #SHQIPËRIA E ARDHMJA JONË DHE #SKAKOHËPËRPUSHIM**

Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore prej nisjes së periudhës katërmujore më datë 13 janar 2023, ashtu si dhe më parë, e deri më sot, në një pjesë të konsiderueshme të Faqeve Zyrtare në Facebook të Bashkive të vendit janë përdorur sloganet elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtag-eve (#).

Tipikisht janë përdorur sloganet:

1. Të bashkuar, jo të ndarë;
2. Shqipëria e ardhmja jonë; dhe
3. S'ka kohë për pushim.

Dy prej këtyre sloganeve janë përdorur fillimisht prej Partisë Socialiste si slogane elektorale gjatë Zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021, e në vazhdim, ndërsa i treti si slogan i Partisë Socialiste prej marsit 2022.

Konkretisht:

1. Slogani "SkaKohëPërPushim", ka qenë zyrtarisht slogan i fushatës elektorale të Partisë Socialiste gjatë Zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021. Kryetari i PS dhe kryeministri i vendit z. Rama, është shprehur para zgjedhjeve të vitit 2021 se "Programi i PS-së do të jetë i shtrirë në kohë, për një Shqipëri të vitit 2030 ndërsa slogan i është: "S'ka kohë për pushim".
2. Slogani "Shqipëria, e ardhmja jonë" është përdorur gjithashtu gjatë fushatës për Zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021 në të gjithë materialet propagandistike të Partisë Socialiste.





Për më shumë shihni link-un: "Shqipëria, e ardhmja jonë"/ Publikohet slogan i PS-së në zgjedhjet e 25 prillit").

3. Slogani "Të bashkuar, jo të ndarë" është slogan i përdorur nga Partia Socialiste në Kongresin e saj të Prillit 2022, si një slogan i cili do të përdorej më pas në mënyrë të vazhdueshme nga Kryeministri Rama dhe në aktivitetet zyrtare të Partisë Socialiste dhe përfaqësuesve të saj.

Për më shumë shihni link-et: - "Të bashkuar, jo të ndarë!"/ Rama prezanton 'sloganin' e ri, "kunjë" për PD?"; - "Rama ndan foton nga Kongresi i PS dhe ka një mesazh: T'i lëmë pas hendeqet politike, të bashkuar dhe jo të ndarë si shqiptarë"; - "Të bashkuar, jo të ndarë", PS mbledh Asamblenë Kombëtare. Gjikhuri: Qëndrimi gjatë në pushtet ka risqet. Garën e kemi me veten".

Postimet e aktiviteteve, njoftimeve apo promovimeve të ndryshme në rrjetin social *Facebook* të Kryeministrit, Ministrave, Deputetëve, Kryetarëve të Bashkive etj., shoqërohen në shumicën e rasteve me tre *hashtag*-et e sipërpërmendura.

Madje, me nisjen e fushatës zgjedhore kanë nisur të përdoren edhe sloganet e reja të fushatës për këto zgjedhje.

Dy sloganet e para janë shpallur publikisht dhe përdorur nga Partia Socialiste si slogane të fushatës elektorale në zgjedhjet e vitit 2021 e në vazhdim, përfshi zgjedhjet e pjesshme të 6 marsit 2022, ndërsa i treti lidhet drejtpërdrejt me Partinë Socialiste e vazhdon e përdoret në mënyrë të vazhdueshme prej përfaqësuesve të saj.

Të tre këto slogane, të konvertuara dhe përdorura edhe si **hashtag-e lidhen dhe identifikojnë drejtpërsëdrejtë Partinë Socialiste**.

**Duke u vendosur, përdorur dhe reklamuar nga institucionet publike dhe drejtuesit e tyre në faqet zyrtare në Facebook, në gjykimin e KRIIK kemi të bëjmë me shpërdorim të autoritetit shtetëror, si dhe përdorim:**

- **të një asemi institucional** (specifikisht të faqes zyrtare në mënyrë të institucionit në mediat sociale si kanal komunikimi publik),

- **të kohës së nëpunësve shtetërorë** (personat e ngarkuar me shpërndarjen e njoftimeve në këto faqe),

- **si dhe të gjithë burimeve të vëna në dispozicion për realizimin e aktivitetit institucional të cilave iu jepen valencë dhe meritë partiake në funksion të një partie politike, çka është në kundërshtim me kuadrin ligjor zgjedhor, si dhe të parimit për ndarjen e shtetit nga partia.**

Ky fenomen vërehet në disa faqe të institucioneve apo edhe drejtuesve të tyre.

Pavarësisht vendimmarrjes së fundit të KSHZ, ku faqet zyrtare të drejtuesve të institucioneve konsiderohen si faqe personale të tyre, KRIIK shpreh sërish qëndrimin dhe rezervat e tij lidhur me këtë vendimarrje, duke ju risjellë në konsideratë diskutimin dhe dakordësinë e arritur në mbledhjen e zhvilluar me Komisionerin dhe drejtueset e KQZ, në datën 13 mars 2023.

Na lejoni edhe në vijim të asaj bisede, por edhe për të risjellë në vëmendje gjykimin e KRIIK, se në faqet e drejtuesve të institucioneve të përfshira, **citohet në mënyrë eksplicite se është faqja zyrtare e drejtuesit të institucionit (Kryetarit të Bashkisë xxx apo Ministrin të xxx)**.

Gjithashtu këto janë faqe në të cilat **në vijimësi postohet vetëm aktiviteti i institucionit të cilin individët në fjalë drejtojnë**, çka në funksionin e saj të përhershëm i jep kësaj faqeje një karakter institucional.

Përpos kësaj, në shumicën dërrmuese të rasteve, faqet zyrtare të bashkive apo edhe të ministrive në publikimet e tyre ripostojnë postime nga faqet e drejtuesve përkatës (*Kryetarit të Bashkisë apo Ministrave*).





Nga vëzhgimi i këtyre faqeve, rezulton se numri i ndjekësve apo shikueshmëria e postimeve në to është disa herë më e lartë në faqet e drejtuesve, çka vjen si rrjedhojë e autoritetit të tyre shtetëror.

Për më tepër, këto faqe nuk janë profile private, të mbyllura, por janë faqe "page" publike si persona publikë për hir të funksionit shtetëror që mbajnë.

Përpos gjithë sa më sipër, edhe si persona politikë, këto drejtues marrin vëmendje publike maksimale dhe valencë të shtuar në pikëpamje të autoritetit kur postojnë veprimtari të institucioneve shtetërore, të cilat janë tërësisht produkt i përdorimit të:

(1) autoritetit shtetëror;

(2) burimeve logjistike e financiare të Bashkive apo Ministrive përkatëse;

(3) burimeve njerëzore të institucioneve (bashki/ministri) që kanë bërë të mundur tërë planifikimin, organizimin, realizimin e veprimtarisë deri edhe postimin në keto faqe zyrtare, duke u paguar me para të buxhetit të shtetit dhe duke harxhuar kohën e punës të paguar për dhe në funksion të aktivitetit të institucionit shtetëror, përfshirë ekspertizën dhe autoritetit e përdorur më vete prej secilit prej nëpunësve publikë të përfshirë.

Së fundi theksohet se, në perceptimin publik, faqet zyrtare të titullarëve ku janë postuar në vijimësi aktiviteti institucional normal e i përditshëm i institucionit, mbytet me postime partiake, politike e zgjedhore, duke dhënë mesazhin e gabuar dhe mos bërë asnjë dallim midis aktivitetit zyrtar të shtetit me atë partiak e politik.

Ndërkohë që një ndarje e tillë duhet të jetë e qartë dhe e prerë si detyrim primar që rrjedh prej Kushtetutës, dokumenteve ndërkombëtare dhe ligjit.

#### Konkretisht:

**5.1. Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-eve të sipërpërmendura gjenden në Faqet Zyrtare të Bashkive dhe Kryetarëve të Bashkive:**

**1. Bashkia Belsh - Kryetar Arif Tafani**

Në faqen zyrtare të Bashkisë Belsh është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.

Në faqen zyrtare të kryetarit të Bashkisë në foton e profilit është vendosur një foto me sloganin e Partisë Socialiste.

**2. Bashkia Bulqizë - Kryetar Lefter Alla**

Në faqen zyrtare të Bashkisë Bulqizë është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.

Në faqen zyrtare të kryetarit të Bashkisë në foton e profilit është vendosur një foto me sloganin e Partisë Socialiste.

**3. Bashkia Cërrik - Kryetar Andis Salla**

Në faqen zyrtare të Bashkisë Cërrik dhe të kryetarit të saj, është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.

**4. Bashkia Elbasan - Kryetar Gledian Llatja**

Në faqen zyrtare të Bashkisë Elbasan dhe të kryetarit të saj, është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.

Në faqen zyrtare të kryetarit të Bashkisë në foton e mbulimit është vendosur një foto me sloganin e Partisë Socialiste.

**5. Bashkia Fier - Kryetar Armando Subashi**





- Në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë Fier është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.
6. **Bashkia Gramsh - Kryetar Klodian Taçe**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Gramsh dhe Kryetarit të Bashkisë Gramsh është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.
  7. **Bashkia Kavajë - Kryetar Redjan Krali**  
Në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë Kavajë është përdorur hashtag #SkaKohëPërPushim #14maj.
  8. **Bashkia Këlcyrë - Kryetar Klement Ndoni**  
Në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.
  9. **Bashkia Kolonje - Kryetar Erion Isai**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Kolonjë është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.
  10. **Bashkia Konispol - Kryetar Shuaip Beqiri**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Konispol është përdorur hashtag #SkaKohëPërPushim.
  11. **Bashkia Kukës - Kryetar Safet Gjici**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Kukës është përdorur hashtag #SkaKohëPërPushim.
  12. **Bashkia Lezhe - Kryetar Pjerin Ndreu**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë dhe të Kryetarit të Bashkisë është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.
  13. **Bashkia Librazhd - Kryetar Kastriot Gurra**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Librazhd dhe të Kryetarit të Bashkisë është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.
  14. **Bashkia Lushnje - Kryetare Eriselda Sefa**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Lushnje është përdorur hashtag #SkaKohëPërPushim.
  15. **Bashkia Mallakastër - Kryetar Qerim Ismailaj**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Mallakastër dhe të Kryetarit të Bashkisë është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.  
Në faqen zyrtare të kryetarit të Bashkisë në foton e mbulimit është vendosur një foto me sloganin e Partisë Socialiste.
  16. **Bashkia Poliçan- Kryetar Adriatik Zotkaj**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Poliçan është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.
  17. **Bashkia Prrenjas - Kryetar Nuri Belba**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Prrenjas dhe të Kryetarit të Bashkisë është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.
  18. **Bashkia Pustec- Kryetar Pali Kolefski**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Pustec është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.
  19. **Bashkia Roskovec- Kryetare Majlinda Bufi**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec dhe të Kryetares së Bashkisë është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.
  20. **Bashkia Shijak- Kryetar Elton Arbana**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Shijak është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.
  21. **Blerim Shera – Kryetar i Bashkisë Vorë**  
Në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë në foton e mbulimit është vendosur një foto me sloganin e Partisë Socialiste.

Të gjitha rastet e mësipërme të postimeve me përmbajtje partiake në Faqet Zyrtare të Bashkive dhe kryetarëve të tyre, të detajuara me link-et dhe printscreen-et përkatëse, gjenden bashkëlidhur në **Lidhjen nr. 6.**





## 5.2. Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-eve të sipërpërmendura gjenden në Faqet Zyrtare të Ministrive dhe Ministrave:

1. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë](#)
2. Faqja zyrtare në [Facebook e Zv. Kryeministres dhe Ministres Belinda Balluku](#)
3. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit](#)
4. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministres së Turizmit dhe Mjedisit,](#)
5. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministrisë së Kulturës.](#)
6. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministres së Kulturës,](#)
7. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministrisë së Drejtësisë,](#)
8. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministrit të Brendshëm,](#)
9. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale](#)
10. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale](#)
11. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë](#)
12. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministres së Financave dhe Ekonomisë](#)
13. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministres së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural](#)
14. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministres së Shtetit për Standardet e Shërbimeve](#)
15. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministres së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin](#)
16. Faqja zyrtare në [Facebook e Ministres së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarries](#)

Të gjitha rastet e mësipërme të postimeve me përmbajtje partiake në në Faqet Zyrtare të Ministrive dhe Ministrave, të detajuara me link-et dhe printscreen-et përkatëse, gjenden bashkëlidhur në **Lidhjen nr. 7**.

Në gjykimin e KRIIK, këto postime me përmbajtje partiake në Faqet Zyrtare të Ministrive, Ministrave, Bashkive dhe të Kryetarëve të Bashkive, **përbëjnë shpërdorim të institucionit në funksion të partisë politike**, e konkretisht të subjektit zgjedhor Partia Socialiste.

**KRIIK nxit KQZ-në që të marrë menjëherë masat e nevojshme që të ndalojë shkeljen si dhe të parandalojë me efektivitet përdorimin e burimeve shtetërore në fushatë, përfshirë këtë aspekt jo pak të rëndësishëm, duke u kërkuar institucioneve dhe drejtuesve të tyre të ndalojnë postimet me natyrë partiake, përfshi sloganet elektorale në faqet e tyre, si dhe të pastrojnë postimet e mëparshme.**

Gjithashtu në vijim të qëndrimit të tij, **KRIIK jua paraqet këtë denoncim si indicie juve si institucion i KQZ-së.**

Sipas gjykimit të KRIIK, nevojitet që rastet të merren në konsideratë prej jush, të shqyrtohen duke ndërmarrë hetimin e nevojshëm administrativ dhe vazhduar më pas ndjekjen e procedurave të parashikuara për sanksionimin e shkelësve sipas ligjit.

Në gjykimin e KRIIK, **KQZ-ja nevojitet të sanksionojë përpos titullarëve vendorë edhe subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë**, e cila është përfituesja kryesore nga ky aktivitet i ndaluar (neni 172 pika 1).

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

**Me konsideratë,**

**Për Koalicionin Për Reforma, Integrim**



## dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

### Premto GOGO Kryetar

<sup>11</sup> Dokumenti i Kopenhagës, Neni 5.4 “...ndarje e qartë ndërmjet Shtetit dhe partive politike; në veçanti, partitë politike nuk do të shkrihen me shtetin.”

<sup>12</sup> Doracaku i OSBE/ODIHR për vëzhgimin e financave të fushatës, faqe 22.

\* Ky komunikim me postë elektronike, sipas dakordësisë së arritur midis KQZ-së dhe KRIIK, konsiderohet i njëvlefshëm me komunikimin shkresor.

Për efekt të identifikimit të tij si Dokument në dokumentacionin zyrtar të brendshëm të KRIIK apo përdorimit të mundshëm të tij për nevoja publikimi, teksti i mësipërm futet në formatin shkresor zyrtar me logo të KRIIK dhe mban nr. Prot. 2304/33 K (e-k) , datë 22/04/2023, Tiranë.

#### Coalition for Reforms, Integration and Consolidated Institutions (KRIIK Albania)

A: Rr. "Y. Kuri", Nd.4, H.2, Ap.3, Nj.Adm.5, Tirana, 1019 | Mailing address: P.O.Box. 2396 Tirana, 1001, Albania |

T: + 355 4 2245078 | M: + 355 673890174; + 355 682039297 |

E: info[at]kriik.al; info.kriik[at]gmail.com | W: [www.kriik.al](http://www.kriik.al) |

KRIIK (Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara) ka si mision mbrojtjen dhe garantimin e lirive e të drejtave të njeriut si dhe të dimensionit të plotë të sigurisë njerëzore nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës, qeverisjes demokratike, nxitjes së aktivizmit e të angazhimit qytetar si dhe nxitjes për përgjegjshmëri, transparencë e llogaridhënie të plotë të institucioneve publike dhe politike. / Coalition for Reforms, Integration and Consolidated Institutions (KRIIK Albania) mission is protection and guarantee of human rights and freedoms, as well as the full dimension of human security, through strengthening the rule of law, democratic governance, promotion of civic activism and engagement, and promotion of full transparency and accountability of public and political institutions.

Please consider your environmental responsibility..



**KURSEJMË  
ENERGJINË  
QË TA KEMI!**

Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

The information transmitted in the content of this message is intended only for the individual or the institution to whom it is addressed, may contain confidential and/or privileged material for the recipient only. Each review, transmission, distribution or performance of any other action similar to these, by persons or by entities other than the intended recipient, is prohibited. If you receive this message in error, please contact the sender immediately and delete any transmitted material on your computer. We do not accept no liability related to damage or loss caused by harmful programs or viruses, except in the event of gross negligence, or willful misconduct.







**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Kërkesa nr. 21

Data 6.5.2023  
Nr. Prot 4734

**KËRKUES:** KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

**OBJEKTI:** Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ

**DREJTUAR:** KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë indicie për publikimin e postimeve me përmbajtje elektorale, nga 20 (njëzet) bashki dhe 1 (një) një kryetar bashkie, për të cilat pretendohet nga denoncuesi se postime me përmbajtje partiake në faqet zyrtare të bashkive, përbëjnë përdorim të burimeve publike.

Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link dhe materialeve fotografike, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerëson se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundrvajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të tyre, provohet se të gjitha postimet dhe ripostimet në faqet zyrtare të rrjetit social "Facebook", të bashkive subjekt i këtij denoncimi, janë përdorur hashtag dhe slogane me përmbajtje elektorale.

Nga verifikimet paraprake dhe provat e administruara vlerësoj se faqet e rrjetit social "Facebook", me emrin bashkive objekt denoncimi, janë faqe zyrtare të këtyre institucioneve.

Kodi Zgjedhor në nenin 91, pika 1, parashikon se *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”*. Po ky nen parashikon se *“burime”* quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit.

Vënia në dispozicion e faqeve zyrtare në *“facebook”* apo çdo mjete tjetër elektronik (media sociale) të institucioneve publike për publikimin e postimeve të cilat përmbajnë hashtag #, slogane me karakter politik/elektoral në zgjedhje, apo thirrje për mbështetje në zgjedhje nga ana e këtyre institucioneve përbën përdorim të burimeve publike.

Në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se rasti objekt denoncimi regjistruar me nr. 349 ID, për pikat nga 1-15 dhe 17-20 përbën shkelje të nenit 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor dhe duhet të fshihen menjëherë nga faqja e tyre e rrjetit social.

Për rrjedhojë, referuar nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3000 (tre mijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, si dhe në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat *“dh”, “f”* dhe *“n”*, pika 2, 91, 171, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, *“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”*, vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”, i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, marrjen e masës administrative në vlerën 3 000 (tre mijë) lekë ndaj:

- Z. Arif Tafani, kryetar për bashkinë Belsh;
- Z. Lefter Alla, kryetar për bashkinë Bulqizë;
- Z. Andis Salla, kryetar për bashkinë Cërrik;
- Z. Armando Subashi, kryetar për bashkinë Fier;
- Z. Gledian Llatja, kryetar për bashkinë Elbasan;
- Z. Klodian Taçe, kryetar për bashkinë Gramsh;
- Z. Redjan Krali, kryetar për bashkinë Kavajë;
- Z. Klement Ndoni, kryetar për bashkinë Këlcyrë;
- Z. Erion Isai, kryetar për bashkinë Kolonjë;
- Z. Shuaip Beqiri, kryetar për bashkinë Konispol;
- Z. Safet Gjici, kryetar për bashkinë Kukës;





- Z. Pjerin Ndreu, kryetar për bashkinë Lezhë;
- Z. Kastriot Gurra, kryetar për bashkinë Librazhd;
- Zj. Eriselda Sefa, kryetar për bashkinë Lushnje;
- Z. Qerim Ismailaj, kryetar për bashkinë Mallakastër;
- Z. Nuri Belba, kryetar për bashkinë Prrenjas;
- Z. Pali Kolefski, kryetar për bashkinë Pustec;
- Zj. Majlinda Bufi, kryetar për bashkinë Roskovec;
- Z. Elton Arbana, kryetar për bashkinë Shijak;
- Z. Blerim Shera, kryetar i Bashkisë Vorë.

- Nga të dhënat, rezulton se z. Arif Tafani nuk është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Lefter Alla nuk është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Andis Salla është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Armando Subashi është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Gledian Llatja është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Klodian Taçe nuk është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Redjan Krali nuk është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Klement Ndoni nuk është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Erion Isai nuk është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Shuaip Beqiri nuk është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Safet Gjici është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Pjerin Ndreu nuk është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Kastriot Gurra është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Eriselda Sefa është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Qerim Ismailaj nuk është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Nuri Belba është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Pali Kolefski nuk është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Majlinda Bufi nuk është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Elton Arbana nuk është përsëritës për shkeljen.
- Nga të dhënat, rezulton se z. Blerim Shera nuk është përsëritës për shkeljen.

Bashkëlidhur kërkesës për vendosje të sanksionit administrativ, ju vëmë në dispozicion, provat si më poshtë vijon:

- Vendimi nr. 441, datë 05.05.2023 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 349 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ndaj kryetarit

të bashkisë Belsh, Bulqizë, Cërrik, Elbasan, Fier, Gramsh, Kavajë, Këlcyrë, Kolonjë, Konispol, Kukës, Lezhë, Librazhd, Lushnje, Mallakastër, Poliçan, Prrenjas, Pustec, Roskovec, Shijak dhe Vorë për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023;

- Denoncimi i regjistruar me nr. 349 ID, nga Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) dhe provat bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,


Kopje: 3  
Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:  
E. Mema  
I. Horaniu  
M. Koja  
A. Lamçe  
Y. Merkaç



**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**





**FW: KONSTATIME – Raporti XIV - Gjetje e Rekomandime për javen 14-20 prill 2023, lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve-20230422!**

Ina Horanlliu <Ina.Horanlliu@kqz.gov.al>

Wed 4/26/2023 6:10 PM

To: Marisold Bardhi <Marisold.Bardhi@kqz.gov.al>

441

7 attachments (5 MB)

Lidhje\_1-KRIIK-Permbledhje\_AktiviteteteRaportuaraMeVonese--Rap XIV-20230422.pdf; Lidhje\_3-KRIIK-PostimePartiakePS\_FaqeZyrtareBashkiaKamëz--Rap XIV-20230422.pdf; Lidhje\_4-KRIIK-Fjala\_E\_Veliaj\_MbledhjaEKeshillitBashkiakTirane19prill23--Rap XIV-20230422.pdf; Lidhje\_5-KRIIK-TransmetimiLIVeMedia\_MbledhjaEKeshillitBashkiakTirane19prill23--Rap XIV-20230422.pdf; Lidhje\_6-KRIIK-PostimeMeSloganeElektoralTePSneFaqetEBashkiveEKryetareve--Rap XIV-20230422.pdf; Lidhje\_7-KRIIK-PostimeMeSloganeElektoralTePSneFaqetEMinistriveEMinistrave--Rap XIV-20230422.pdf; Lidhje\_2-KRIIK-AktiviteteteRaportuaraMeVonese--Rap XIV-20230422.xlsx;

**From:** Madalena Koja <Madalena.Koja@kqz.gov.al>

**Sent:** Monday, April 24, 2023 8:31 AM

**To:** Ina Horanlliu <Ina.Horanlliu@kqz.gov.al>; Kejsa Bici <Kejsa.Bici@kqz.gov.al>; Blerta Ereqi <Blerta.Ereqi@kqz.gov.al>

**Subject:** Fwd: KONSTATIME – Raporti XIV - Gjetje e Rekomandime për javen 14-20 prill 2023, lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve-20230422!

Fya

Get [Outlook for Android](#)

**From:** Coalition for Reforms, Integration and Consolidated Institutions (KRIIK Albania) <info@kriik.al>

**Sent:** Monday, April 24, 2023 8:00:31 AM

**To:** Elvira Gaxholli <elvira.gaxholli@kqz.gov.al>

**Cc:** Ilirjan Celibashi <Ilirjan.Celibashi@kqz.gov.al>; Ylli Merkaj <Ylli.Merkaj@kqz.gov.al>; Erton Sinani <Erton.Sinani@kqz.gov.al>; Majlinda Celmeta <Majlinda.Celmeta@kqz.gov.al>; Valbona Ballgjini <Valbona.Ballgjini@kqz.gov.al>; Ermina Allushi <Ermina.Allushi@kqz.gov.al>; Madalena Koja <Madalena.Koja@kqz.gov.al>; Daniela Alimemeti <Daniela.Alimemeti@kqz.gov.al>; Drilona Hoxhaj <Drilona.Hoxhaj@kqz.gov.al>; Dritan Taulla <dritan.taulla@kriik.al>; Antuela Male <antuela.male@kriik.al>;

Premto Gogo <premtogogo@kriik.al>

**Subject:** KONSTATIME – Raporti XIV - Gjetje e Rekomandime për javen 14-20 prill 2023, lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve-20230422!

**Drejtuar:** Komisionit Qendror të Zgjedhjeve  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
z. Ilirjan CELIBASHI

348 -

**Lënda\*:** **KONSTATIME** – Raporti XIV i Gjetjeve dhe Rekomandimeve për javën 14-20 prill 2023, lidhur me raportimet në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së të veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore.

**I Nderuar Z. Komisioner!**



## Të nderuar Kolegë të Administratës së KQZ-së!

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin në vazhdimësi, mund të gjeni në vijim Gjetjet dhe Rekomandimet e Raportit të monitorimit të KRIIK për javën e katërbëdhjetë të funksionimit të mekanizmit të raportimit të institucioneve në ndërfaqe, për periudhën 14 – 20 prill 2023.

Gjatë monitorimit të kësaj jave, KRIIK ka evidentuar disa problematika, si:

1. Raportimi i aktiviteteve me vonesë
2. Raportime ku mungojnë detajet
3. Postimi i aktiviteteve elektorale në faqen zyrtare të Bashkisë
4. Propagandë elektorale në aktivitete institucionale
5. Përdorimi në postimet e aktiviteteve institucionale të hashtag-eve slogane elektorale: #TëBashkuarJoTëNdarë; #ShqipëriaEArdhmjaJonë dhe #SkaKohëPërPushim

### Konkretisht:

## 1. RAPORTIMI I AKTIVITETEVE ME VONESË

Pavarësisht minimizimit, vijon ende praktika e raportimit të aktiviteteve me vonesë.

Nga monitorimi i bërë rezulton se **rreth 1.9% e raportimeve në javën e katërbëdhjetë janë me vonesë.**

Specifikisht, nga 206 aktivitete të raportuara gjatë kësaj periudhe, 4 janë raportuar me vonesë (për më shumë shih **Lidhjen 1**, e cila përmbledh të dhënat për raportimet me vonesë, si dhe **Lidhjen 2** me listën e detajuar të këtyre aktiviteteve, së bashku me të dhënat përkatëse referuar ndërfaqes së aktiviteteve në faqen e internetit të KQZ-së).

Numri total i institucioneve raportuese përgjatë periudhës kohore që mbulon ky raport është 51, nga të cilat 4 kanë raportuar së paku një aktivitet përtej afatit të përcaktuar ligjor.

*Ritheksohet se këto shifra i referohen vetëm raportimeve të kryera nga institucionet në ndërfaqe dhe që mund të aksesohen aty.*

*Nëse në KQZ kanë mbërritur raportime me anë të postës elektronike, apo me mjete të tjera të komunikimit dhe nuk janë hedhur në ndërfaqe, këto nuk përfshihen në të dhënat e mësipërme.*

**KRIIK shpreh vlerësimin mbi disa vendimmarrje të KSHZ për ndalimin paraprakisht të aktiviteteve të raportuara me vonesë prej institucioneve, por kjo duhet të kthehet në një praktikë solide e të menjëhershme të administratës së KQZ-së për të ndaluar çdo aktivitet sapo ai të hidhet në ndërfaqen e raportimit dhe konstatohet se është raportuar jashtë afatit.**

Ky qëndrim është në linjë me rekomandimet që KRIIK ka bërë në vazhdimësi në raportet e mëparshme.

Gjithashtu, KRIIK risjell në vëmendje se **ende mbeten relevante Rekomandimet konkrete**, qoftë në nivel politik e të përgjithshëm, qoftë në nivel teknik e konkret, të **përcjella** nëpërmjet Raporteve të mëparshme të Monitorimit, e veçanërisht atyre të tre javëve të para.

## 2. RAPORTIME KU MUNGOJNË DETAJET

Vërehet se vijon mungesa e detajeve në një numër raportimesh, detaje të cilat do të bënin të mundur që monitoruesit e KQZ-së apo të tjerë aktorë të interesuar të mund të marrin pjesë apo t'i vëzhgojnë eventet.





Gjithashtu, sikurse është konstatuar edhe nga ju si administratë, mungesa e detajeve sjell një problematikë serioze në monitorimin e aktiviteteve, veçanërisht për evidentimin e aktiviteteve të raportuara. Aktivitetet e raportuara pa detaje pamundësojnë identifikimin e tyre, pasi nuk është e mundur të përcaktohet konkretisht aktiviteti.

Të tilla raste janë të shumta, por sillen si shembuj ilustrues vetëm dy prej tyre:

- “Java boterore e vaksinimit -Fushata HPV” për të cilin tek fusha “Vendi i Zhvillimit” plotësohet “Tiranë”, Linku i raportimit: <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/04/20/java-boterore-e-vaksinimit-fushata-hpv/>.
- “Mbjellje pemesh me gjinnazistet” për të cilin tek fusha “Vendi i Zhvillimit” plotësohet “Tiranë”. Linku i raportimit: <https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/04/20/mbjellje-pemesh-me-gjinnazistet/>.

Po ashtu, në raportimet e Bashkisë Tiranë nuk jepet emri i personit përgjegjës, por veçse emri i pozicionit, edhe ai i paspecifikuar. Konkretisht: “Personi përgjegjës për raportim: Drejtor i Përgjithshëm”; - “Personi i ngarkuar nga ligji për raportim (Sekretari i Përgjithshëm/drejtori përgjithshëm/drejtuesi më i lartë administrativ): Drejtor i Përgjithshëm”.

Në vazhdimësi të sa është kërkuar në raportet e mëparshme, është me vend që KQZ t’u tërheqë vëmendjen institucioneve raportuese në lidhje me këtë fenomen, pasi kjo mënyrë raportimi përbën së paku mos përmbushje në mënyrën e duhur të detyrimit ligjor.

### 3. POSTIMI I AKTIVITETEVE ELEKTORALE NË FAQEN ZYRTARE TË BASHKISË

Faqet zyrtare në rrjetet sociale, të institucioneve dhe drejtuesve të tyre, kanë të njëjtën rëndësi dhe duhet t’i nënshtrohen të njëjtave rregullave sikurse faqet zyrtare të internetit të tyre.

Madje, duke konsideruar audiencën shumë herë më të lartë të tyre dhe përdorimin e gjerë nga njerëzit, institucionet dhe drejtuesit e tyre kanë një fokus disa herë më të madh në këto platforma komunikimi sesa në ato tradicionale.

Në vazhdim të monitorimit të tyre përgjatë periudhës parazgjedhore, KRIIK, përpos të tjerave, ka identifikuar dhe ju ka përcjellë pesë raste ku në Faqet Zyrtare të disa Bashkive në Facebook, postohen apo shpërndahen njoftime mbi aktivitete partiake, e konkretisht të Partisë Socialiste të Shqipërisë (Raporti i javës së 9-të të monitorimit). Konkretisht, në të përfshiheshin Bashkitë Poliçan, Kamëz, Kurbin, Konispol, Memaliaj.

Ndërkohë që për tre nga bashkitë e sipërpërmendura KQZ ka marrë vendim dhe pushuar hetimin administrativ (vendimi nr. 266 datë 05.04.2023), për dy prej tyre, konkretisht Bashkia Kamëz dhe Bashkia Poliçan, nuk ka ende vendimmarrje.

KRIIK ka vijuar monitorimin e këtyre faqeve, dhe konstaton se Bashkia Kamëz, vijon ende me postimet në faqen zyrtare Facebook të Bashkisë, të aktivitetit elektoral të kryetarit aktual dhe njëkohësisht kandidatit të Partisë Socialiste në këtë bashki.

Disa nga postimet përkatëse mund të aksesohen në linqet e mëposhtme, ndërsa në Lidhjen nr: 3 bashkëlidhur mund të gjeni foto/printscreen të postimeve në faqen e Bashkisë Kamëz:

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0yfALJYhn6y8jUXJmu9UiUTDgQevG4vxG1fpvU4y7UCvLVaKev3m18PXHAjLTmR\\_Utl&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0yfALJYhn6y8jUXJmu9UiUTDgQevG4vxG1fpvU4y7UCvLVaKev3m18PXHAjLTmR_Utl&id=100077339029573) ;





[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0nbDxk2jRjnd9HhJCMtLrdb55AxëMyNsghJd4h1tAvUJHĒnNdjBN14DKozFgaLjfel&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0nbDxk2jRjnd9HhJCMtLrdb55AxëMyNsghJd4h1tAvUJHĒnNdjBN14DKozFgaLjfel&id=100077339029573) ;

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid025MXFHcn2RFee6aZMgsgpbtAuH3RoPqxZ57qhDVOëpĒVmdGMm5ëPXMëĒlĒRs1E9LI&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid025MXFHcn2RFee6aZMgsgpbtAuH3RoPqxZ57qhDVOëpĒVmdGMm5ëPXMëĒlĒRs1E9LI&id=100077339029573) ;

[https://www.facebook.com/permalink.php?story\\_fbid=pfbid0dUKVpĒYuDnFSjVhfu3ZOragSMs4ScBR6nYCC2CA2më6dzptiëAqYh2FPZzzj9Twcl&id=100077339029573](https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid0dUKVpĒYuDnFSjVhfu3ZOragSMs4ScBR6nYCC2CA2më6dzptiëAqYh2FPZzzj9Twcl&id=100077339029573) ;

Në gjykimin e KRIIK, këto postime me përmbajtje partiake në Faqen Zyrtare të Bashkisë, sikurse ju është bërë me dije edhe më parë, përbëjnë haptazi shpërdorim të burimeve dhe autoritetit të institucionit në funksion të partisë politike, e konkretisht të subjektit zgjedhor Partia Socialiste.

**KRIIK nxit KQZ-në t'i marrë në konsideratë këto denoncime e procedojë sipas parashikimeve ligjore për të sanksionuar jo vetëm institucionin, por edhe Kryetarët e Bashkive si dhe subjektin zgjedhor Partia Socialiste**, sipas nenit 172 pika të Kodit Zgjedhor, pasi në favor të kësaj të fundit janë kryer shkeljet e mësipërme.

KQZ-ja nuk duhet në asnjë rast të tregohet tolerante në rastet e moskthimit përgjigje prej institucioneve sikurse ka ndodhur në disa prej hetimeve administrative të zhvilluara, por duhet t'i konsiderojë këto raste si mosbashkëpunim me të duke vepruar sipas Neni 169 "Mosbashkëpunimi me KQZ-në" të Kodit Zgjedhor.

#### 4. PROPAGANDË ELEKTORALE NË AKTIVITETE INSTITUCIONALE

Në vijim të monitorimit, KRIIK ka evidentuar në mbledhjen e datës 19 prill 2023 të Këshillit Bashkiak të Tiranës shkelje që përbëjnë përdorim të burimeve shtetërore për avantazh elektoral nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj.

Paraprakisht, rikthejmë në vëmendjen tuaj se përdorimi i burimeve zyrtare në fushatë për avantazh elektoral nuk konsiston vetëm në përdorimin e burimeve me efekt financiar apo atyre njerëzore, por shumë më tepër se kaq.

Në frymën e ndarjes së partisë nga shteti,<sup>[i]</sup> OSBE/ODIHR e përkufizon përdorimin e burimeve shtetërore si "...avantazh i padrejtë nga disa parti ose kandidatë, nëpërmjet përdorimit të pozitave të tyre zyrtare ose lidhjeve me institucionet qeveritare, për të ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve"<sup>[ii]</sup>.

Konkretisht, fjala e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj, gjatë mbledhjes së Këshillit Bashkiak të 19 prillit 2023, në gjykimin e KRIIK është një fjalë me natyrë të pastër elektorale.

Përgjatë gjithë fjalimit, z. Veliaj ka bërë një numër komentesh me natyrë të qartë elektorale, duke komentuar negativisht subjekte zgjedhore konkurrenente në këto zgjedhje (konkretisht në lidhje me Koalicionin "Bashkë Fitojmë"), duke komentuar elementë të programit elektoral të kandidatit për Kryetar Bashkie të po këtij Koalicioni, madje edhe duke u shprehur në lidhje me pritshmëritë e rezultatit zgjedhor në favor të tij.

Për më tepër, në një numër të komenteve të kryera është përdorur një gjuhë denigruese si dhe sulme personale.



Për më shumë në lidhje me komentet specifike, shih bashkëlidhur në Lidhjen nr. 4, transkriptin e fjalës së z. Veliaj gjatë Mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 19 prill 2023, ku disa prej elementëve më të dukshëm janë të markuara ne shkrim të errët.

Theksohet se, mbledhjet e Këshillit Bashkiak të Tiranës janë **mbledhje të institucionit të Bashkisë së Tiranës dhe z. Veliaj ishte në këtë mbledhje në funksionin e tij institucional si Kryetar i Bashkisë, dhe jo si kandidat**. Pra komentet e kryera në këtë mbledhje përbëjnë përdorim të një eventi institucional për fushatë elektorale.

Për më tepër, mbledhja e djeshme e Këshillit Bashkiak ishte një mbledhje e transmetuar gjerësisht në media. Përveçse e transmetuar në kohë reale në faqen e Bashkisë Tiranë në Facebook (çka përbën edhe një tjetër mënyrë se si burimet institucionale janë përdorur për efekte fushate) apo të tjera faqe në rrjete sociale, ajo është transmetuar po në kohë reale nga së paku 5 televizione (*shih Lidhjen Nr. 5, foto/screenshots nga mediat që kanë transmetuar në kohë reale Mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës 19 prill 2023*).

Gjithë sa më sipër bëhet akoma më problematike nëse konsiderojmë se tanimë jemi në fazën më intensive të takimeve të kandidatëve me elektoratin, atë të fushatës zgjedhore.

**Kryetari i Bashkisë Tiranë e përdori mbledhjen e djeshme të Këshillit Bashkiak dhe pozicionin e tij zyrtar si Kryebashkiak për të përfituar një avantazh elektoral ndaj konkurrentëve të vet në garë, duke dëmtuar në këtë mënyrë barazinë në garë, në shkelje të parimeve për zgjedhje të ndershme dhe demokratike, përveçse në shkelje të Kodit Zgjedhor dhe të Vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator.**

Përpos sa më sipër, KRIIK gjithashtu sjell në vëmendjen tuaj se natyra e vendimeve të djeshme të Këshillit Bashkiak është e tillë që qartas përbëjnë vendime me efekt elektoral, për të cilat KQZ-ja duhet të investohet për të mbajtur qëndrimin e duhur që ligji i ngarkon.

Bazuar në sa më sipër, KRIIK i bën thirrje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të veprojë sipas parashikimeve ligjore në fuqi, duke sanksionuar Kryetarin e Bashkisë Tiranë për përdorimin e një aktiviteti institucional për qëllime elektorale.

Në linjë edhe me denoncimet e mëparshme të sjella, KRIIK gjithashtu rithekson se përbën domosdoshmëri që KQZ-ja të vërë para përgjegjësisë ligjore gjithashtu Subjektin Zgjedhor Partia Socialiste, në avantazh të të cilit është kryer shkelja, në përputhje me pikën 1 të nenit 172 të Kodit Zgjedhor.

## **5. PËRDORIMI NË POSTIMET E AKTIVITETEVE INSTITUCIONALE TË HASHTAG-EVE SLOGANE ELEKTORALE: #TËBASHKUARJOTËNDARË; #SHQIPËRIA E ARDHMJA JONË DHE #SKAKOHËPËRPUSHIM**

Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore prej nisjes së periudhës katërmujore më datë 13 janar 2023, ashtu si dhe më parë, e deri më sot, në një pjesë të konsiderueshme të Faqeve Zyrtare në Facebook të Bashkive të vendit janë përdorur sloganet elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtag-eve (#).

Tipikisht janë përdorur sloganet:

1. Të bashkuar, jo të ndarë;
2. Shqipëria e ardhmja jonë; dhe
3. S'ka kohë për pushim.





Dy prej këtyre sloganeve janë përdorur fillimisht prej Partisë Socialiste si slogane elektorale gjatë Zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021, e në vazhdim, ndërsa i treti si slogan i Partisë Socialiste prej marsit 2022.

Konkretisht:

1. Slogani “SkaKohëPërPushim”, ka qenë zyrtarisht slogani i fushatës elektorale të Partisë Socialiste gjatë Zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2021.  
Kryetari i PS dhe kryeministri i vendit z. Rama, është shprehur para zgjedhjeve të vitit 2021 se “Programi i PS-së do të jetë i shtrirë në kohë, për një Shqipëri të vitit 2030 ndërsa slogani është: “S’ka kohë për pushim”.
2. Slogani “Shqipëria, e ardhmja jonë” është përdorur gjithashtu gjatë fushatës për Zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2021 në të gjithë materialet propagandistike të Partisë Socialiste.  
Për më shumë shihni link-un: “Shqipëria, e ardhmja jonë”/ Publikohet slogani i PS-së në zgjedhjet e 25 prillit).
3. Slogani “Të bashkuar, jo të ndarë” është slogani i përdorur nga Partia Socialiste në Kongresin e saj të Prillit 2022, si një slogan i cili do të përdorej më pas në mënyrë të vazhdueshme nga Kryeministri Rama dhe në aktivitetet zyrtare të Partisë Socialiste dhe përfaqësuesve të saj.  
Për më shumë shihni link-et: - “Të bashkuar, jo të ndarë!”/ Rama prezanton ‘sloganin’ e ri, “kunjë” për PD?; - “Rama ndan foton nga Kongresi i PS dhe ka një mesazh: T’i lëmë pas hendeqet politike, të bashkuar dhe jo të ndarë si shqiptarë”; - “Të bashkuar, jo të ndarë”, PS mbledh Asamblenë Kombëtare. Gjijnuri: Oëndrimi gjatë në pushtet ka risqet. Garën e kemi me veten.

Postimet e aktiviteteve, njoftimeve apo promovimeve të ndryshme në rrjetin social *Facebook* të Kryeministrit, Ministrave, Deputetëve, Kryetarëve të Bashkive etj., shoqërohen në shumicën e rasteve me tre *hashtag*-et e sipërpërmendura.

Madje, me nisjen e fushatës zgjedhore kanë nisur të përdoren edhe sloganet e reja të fushatës për këto zgjedhje.

Dy sloganet e para janë shpallur publikisht dhe përdorur nga Partia Socialiste si slogane të fushatës elektorale në zgjedhjet e vitit 2021 e në vazhdim, përfshi zgjedhjet e pjesshme të 6 marsit 2022, ndërsa i treti lidhet drejtpërdrejt me Partinë Socialiste e vazhdon e përdoret në mënyrë të vazhdueshme prej përfaqësuesve të saj.

Të tre këto slogane, të konvertuara dhe përdoruara edhe si **hashtag-e lidhen dhe identifikojnë drejtpërsëdrejtë Partinë Socialiste**.

**Duke u vendosur, përdorur dhe reklamuar nga institucionet publike dhe drejtuesit e tyre në faqet zyrtare në Facebook, në gjykimin e KRIIK kemi të bëjmë me shpërdorim të autoritetit shtetëror, si dhe përdorim:**

- të një asemi institucional (specifikisht të faqes zyrtare në mënyrë të institucionit në mediat sociale si kanal komunikimi publik),

- të kohës së nëpunësve shtetërorë (personat e ngarkuar me shpërndarjen e njoftimeve në këto faqe),

- si dhe të gjithë burimeve të vëna në dispozicion për realizimin e aktivitetit institucional të cilave iu jepen valencë dhe meritë partiake në funksion të një partie politike, çka është në kundërshtim me kuadrin ligjor zgjedhor, si dhe të parimit për ndarjen e shtetit nga partia.



Ky fenomen vërehet në disa faqe të institucioneve apo edhe drejtuesve të tyre.

Pavarësisht vendimmarrjes së fundit të KSHZ, ku faqet zyrtare të drejtuesve të institucioneve konsiderohen si faqe personale të tyre, KRIIK shpreh sërish qëndrimin dhe rezervat e tij lidhur me këtë vendimmarrje, duke ju risjellë në konsideratë diskutimin dhe dakordësinë e arritur në mbledhjen e zhvilluar me Komisionerin dhe drejtueset e KQZ, në datën 13 mars 2023.

Na lejoni edhe në vijim të asaj bisede, por edhe për të risjellë në vëmendje gjykimin e KRIIK, se në faqet e drejtuesve të institucioneve të përfshira, **citohet në mënyrë eksplicite se është faqja zyrtare e drejtuesit të institucionit (Kryetarit të Bashkisë xxx apo Ministrin të xxx).**

Gjithashtu këto janë faqe në të cilat në vijimësi postohet vetëm aktiviteti i institucionit të cilin individët në fjalë drejtojnë, çka në funksionin e saj të përhershëm i jep kësaj faqeje një karakter institucional.

Përpos kësaj, në shumicën dërrmuese të rasteve, faqet zyrtare të bashkive apo edhe të ministrive në publikimet e tyre ripostojnë postime nga faqet e drejtuesve përkatës (*Kryetarit të Bashkisë apo Ministrave*).

Nga vëzhgimi i këtyre faqeve, rezulton se numri i ndjekësve apo shikueshmëria e postimeve në to është disa herë më e lartë në faqet e drejtuesve, çka vjen si rrjedhojë e autoritetit të tyre shtetëror.

Për më tepër, këto faqe nuk janë profile private, të mbyllura, por janë faqe "page" publike si persona publike për hir të funksionit shtetëror që mbajnë.

Përpos gjithë sa më sipër, edhe si persona politike, këto drejtues marrin vëmendje publike maksimale dhe valencë të shtuar në pikëpamje të autoritetit kur postojnë veprimtari të institucioneve shtetërore, të cilat janë tërësisht produkt i përdorimit të:

(1) autoritetit shtetëror;

(2) burimeve logjistike e financiare të Bashkive apo Ministrive përkatëse;

(3) burimeve njerëzore të institucioneve (bashki/ministri) që kanë bërë të mundur tërë planifikimin, organizimin, realizimin e veprimtarisë deri edhe postimin në keto faqe zyrtare, duke u paguar me para të buxhetit të shtetit dhe duke harxhuar kohën e punës të paguar për dhe në funksion të aktivitetit të institucionit shtetëror, përfshirë ekspertizën dhe autoritetin e përdorur më vete prej secilit prej nëpunësve publike të përfshirë.

Së fundi theksohet se, në perceptimin publik, faqet zyrtare të titullarëve ku janë postuar në vijimësi aktiviteti institucional normal e i përditshëm i institucionit, mbytet me postime partiake, politike e zgjedhore, duke dhënë mesazhin e gabuar dhe mos bërë asnjë dallim midis aktivitetit zyrtar të shtetit me atë partiak e politik.

Ndërkohë që një ndarje e tillë duhet të jetë e qartë dhe e prerë si detyrim primar që rrjedh prej Kushtetutës, dokumenteve ndërkombëtare dhe ligjit.

Konkretisht:

350

**5.1. Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-eve të sipërpërmendura gjenden në Faqet Zyrtare të Bashkive dhe Kryetarëve të Bashkive:**

#### 1. Bashkia Belsh - Kryetar Arif Tafani

Në faqen zyrtare të Bashkisë Belsh është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.





- Në faqen zyrtare të kryetarit të Bashkisë në foton e profilit është vendosur një foto me sloganin e Partisë Socialiste.
2. **Bashkia Bulqizë - Kryetar Lefter Alla**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Bulqizë është përdorur hashtag [#ShqipëriaEardhmjaJonë](#) ; [#SkaKohëPërPushim](#).  
Në faqen zyrtare të kryetarit të Bashkisë në foton e profilit është vendosur një foto me sloganin e Partisë Socialiste.
  3. **Bashkia Cërrik - Kryetar Andis Salla**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Cërrik dhe të kryetarit të saj, është përdorur hashtag [#ShqipëriaEardhmjaJonë](#) ; [#SkaKohëPërPushim](#).
  4. **Bashkia Elbasan - Kryetar Gledian Llatja**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Elbasan dhe të kryetarit të saj, është përdorur hashtag [#ShqipëriaEardhmjaJonë](#) ; [#SkaKohëPërPushim](#).  
Në faqen zyrtare të kryetarit të Bashkisë në foton e mbulimit është vendosur një foto me sloganin e Partisë Socialiste.
  5. **Bashkia Fier - Kryetar Armando Subashi**  
Në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë Fier është përdorur hashtag [#ShqipëriaEardhmjaJonë](#) ; [#SkaKohëPërPushim](#).
  6. **Bashkia Gramsh - Kryetar Klodian Taçe**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Gramsh dhe Kryetarit të Bashkisë Gramsh është përdorur hashtag [#ShqipëriaEardhmjaJonë](#) ; [#SkaKohëPërPushim](#).
  7. **Bashkia Kavajë - Kryetar Redjan Krali**  
Në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë Kavajë është përdorur hashtag [#SkaKohëPërPushim](#) #14maj.
  8. **Bashkia Këlcyrë - Kryetar Klement Ndoni**  
Në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë Këlcyrë është përdorur hashtag [#ShqipëriaEardhmjaJonë](#) ; [#SkaKohëPërPushim](#).
  9. **Bashkia Kolonjë - Kryetar Erion Isai**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Kolonjë është përdorur hashtag [#ShqipëriaEardhmjaJonë](#) ; [#SkaKohëPërPushim](#).
  10. **Bashkia Konispol - Kryetar Shuaip Beqiri**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Konispol është përdorur hashtag [#SkaKohëPërPushim](#).
  11. **Bashkia Kukës - Kryetar Safet Gjici**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Kukës është përdorur hashtag [#SkaKohëPërPushim](#).
  12. **Bashkia Lezhe - Kryetar Pjerin Ndreu**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë dhe të Kryetarit të Bashkisë është përdorur hashtag [#ShqipëriaEardhmjaJonë](#) ; [#SkaKohëPërPushim](#).
  13. **Bashkia Librazhd - Kryetar Kastriot Gurra**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Librazhd dhe të Kryetarit të Bashkisë është përdorur hashtag [#ShqipëriaEardhmjaJonë](#) ; [#SkaKohëPërPushim](#).
  14. **Bashkia Lushnje - Kryetare Eriselda Sefa**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Lushnje është përdorur hashtag [#SkaKohëPërPushim](#).
  15. **Bashkia Mallakastër - Kryetar Qerim Ismailaj**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Mallakastër dhe të Kryetarit të Bashkisë është përdorur hashtag [#ShqipëriaEardhmjaJonë](#) ; [#SkaKohëPërPushim](#).  
Në faqen zyrtare të kryetarit të Bashkisë në foton e mbulimit është vendosur një foto me sloganin e Partisë Socialiste.
  16. **Bashkia Poliçan- Kryetar Adriatik Zotkaj**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Poliçan është përdorur hashtag [#ShqipëriaEardhmjaJonë](#) ; [#SkaKohëPërPushim](#).
  17. **Bashkia Prrenjas - Kryetar Nuri Belba**  
Në faqen zyrtare të Bashkisë Prrenjas dhe të Kryetarit të Bashkisë është përdorur hashtag [#ShqipëriaEardhmjaJonë](#) ; [#SkaKohëPërPushim](#).
  18. **Bashkia Pustec- Kryetar Pali Kolefski**



Në faqen zyrtare të Bashkisë Pustec është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.

19. **Bashkia Roskovec- Kryetare Majlinda Bufi**

Në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec dhe të Kryetares së Bashkisë është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.

20. **Bashkia Shijak- Kryetar Elton Arbana**

Në faqen zyrtare të Bashkisë Shijak është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkaKohëPërPushim.

21. **Blerim Shera – Kryetar i Bashkisë Vorë**

Në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë në foton e mbulimit është vendosur një foto me sloganin e Partisë Socialiste.

Të gjitha rastet e mësipërme të postimeve me përmbajtje partiake në Faqet Zyrtare të Bashkive dhe kryetarëve të tyre, të detajuara me link-et dhe printscreen-et përkatëse, gjenden bashkëlidhur në **Lidhjen nr. 6**.

## 5.2. Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-eve të sipërpërmendura gjenden në Faqet Zyrtare të Ministrive dhe Ministrave:

1. Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë
2. Faqja zyrtare në Facebook e Zv. Kryeministres dhe Ministres Belinda Balluku
3. Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit
4. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Turizmit dhe Mjedisit,
5. Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Kulturës.
6. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Kulturës,
7. Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Drejtësisë,
8. Faqja zyrtare në Facebook e Ministrit të Brendshëm,
9. Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
10. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
11. Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
12. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Financave dhe Ekonomisë
13. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
14. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Shtetit për Standardet e Shërbimeve
15. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin
16. Faqja zyrtare në Facebook e Ministres së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Të gjitha rastet e mësipërme të postimeve me përmbajtje partiake në Faqet Zyrtare të Ministrive dhe Ministrave, të detajuara me link-et dhe printscreen-et përkatëse, gjenden bashkëlidhur në **Lidhjen nr. 7**.

Në gjykimin e KRIIK, këto postime me përmbajtje partiake në Faqet Zyrtare të Ministrive, Ministrave, Bashkive dhe të Kryetarëve të Bashkive, **përbëjnë shpërdorim të institucionit në funksion të partisë politike**, e konkretisht të subjektit zgjedhor Partia Socialiste.

**KRIIK nxit KQZ-në që të marrë menjëherë masat e nevojshme që të ndalojë shkeljen si dhe të parandalojë me efektivitet përdorimin e burimeve shtetërore në fushatë, përfshirë këtë aspekt jo pak të rëndësishëm, duke u kërkuar institucioneve dhe drejtuesve të tyre të ndalojnë postimet me natyrë partiake, përfshi sloganet elektorale në faqet e tyre, si dhe të pastrojnë postimet e mëparshme.**

Gjithashtu në vijim të qëndrimit të tij, **KRIIK jua paraqet këtë denoncim si indicie juve si institucion i KQZ-së.**





Sipas gjykimit të KRIIK, nevojitet që rastet të merren në konsideratë prej jush, të shqyrtohen duke ndërmarrë hetimin e nevojshëm administrativ dhe vazhduar më pas ndjekjen e procedurave të parashikuara për sanksionimin e shkelësve sipas ligjit.

Në gjykimin e KRIIK, KQZ-ja nevojitet të sanksionojë përpos titullarëve vendorë edhe subjektin zgjedhor **Partia Socialiste e Shqipërisë**, e cila është përfituesja kryesore nga ky aktivitet i ndaluar (neni 172 pika l).

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

**Me konsideratë,**

**Për Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto GOGO  
Kryetar**

[i] Dokumenti i Kopenhagës, Neni 5.4 "...ndarje e qartë ndërmjet Shtetit dhe partive politike; në veçanti, partitë politike nuk do të shkrihen me shtetin."

[ii] Dorçicaku i OSBE/ODIHR për vëzhgimin e financave të fushatës, faqe 22.

\* Ky komunikim me postë elektronike, sipas dakordësisë së arritur midis KQZ-së dhe KRIIK, konsiderohet i njëvlefshëm me komunikimin shkresor.

Për efekt të identifikimit të tij si Dokument në dokumentacionin zyrtar të brendshëm të KRIIK apo përdorimit të mundshëm të tij për nevoja publikimi, teksti i mësipërm futet në formatin shkresor zyrtar me logo të KRIIK dhe mban nr. Prot. 2304/33 K (e-k), datë 22/04/2023, Tiranë.

**Coalition for Reforms, Integration and Consolidated Institutions (KRIIK Albania)**

A: Rr. "Y. Kurti", Nd.4, H.2, Ap.3, Nj.Adm.5, Tirana, 1019 | Mailing address: P.O.Box. 2396 Tirana, 1001, Albania |

T: + 355 4 2245078 | M: + 355 673890174; + 355 682039297 |

E: info[at]kriik.al; info.kriik[at]gmail.com | W: [www.kriik.al](http://www.kriik.al) |

KRIIK (Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara) ka si mision mbrojtjen dhe garantimin e lirisë e të drejtave të njeriut si dhe të dimensionit të plotë të sigurisë njerëzore nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës, qeveritjes demokratike, nxitjes së aktivizmit e të angazhimit qytetar si dhe nxitjes për përgjegjshmëri, transparencë e llogaridhënie të plotë të institucioneve publike dhe politike. / Coalition for Reforms, Integration and Consolidated Institutions (KRIIK Albania) mission is protection and guarantee of human rights and freedoms, as well as the full dimension of human security, through strengthening the rule of law, democratic governance, promotion of civic activism and engagement, and promotion of full transparency and accountability of public and political institutions.

Please consider your environmental responsibility.






1

Lidhja nr. 6 Postime të shogëruara me përdorimin e hashtag-ëve sloganë elektorale të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkiwe dhe Kryetarëve të Bashkiwe

**1. Bashkia Belsh - Kryetar ARIF TAFANI**

Në faqen zyrtare të Bashkisë Belsh është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkakOhePërPushim.

Në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë në foton e profilit është vendosur një foto me sloganin e Partisë Socialiste.







22

**Lidhja nr. 6** Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-eve sloganë elektoralë të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkiave dhe Kryetarëve të Bashkiave

**2. Bashkia Bulqizë - Kryetar Lefter Alla**

Në faqen zyrtare të Bashkisë Bulqizë është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJone; #SkakohëPërPushim. Në faqen zyrtare të kryetarit të Bashkisë në foton e profilit është vendosur një foto me sloganin e Partisë Socialiste.






3

**Lidhja nr. 6** Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-ëve sloganë elektoralë të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkiave dhe Kryetarëve të Bashkiave

**3. Bashkia Çërrik - Kryetar Andis Salla**

Në faqen zyrtare të Bashkisë Çërrik dhe të kryetarit të saj, është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJone ; #SkaKohëPërPushim.







4

Lidhja nr. 6 Postime të shogëruara me përdorimin e hashtag-ëve sloganë elektoralë të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkiave dhe Kryetarëve të Bashkiave

### 5. Bashkia Fier - Kryetar Armando Subashi

Në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë Fier është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkakohetPërPushim.







5

**Lidhja nr. 6** Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-eve sloganë elektoralë të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkië dhe Kryetarëve të Bashkië

**4. Bashkia Elbasan - Kryetar Gledian Lafja**


Në faqen zyrtare të Bashkisë Elbasan dhe të kryetarit të saj, është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkakohëPërPushim. Në faqen zyrtare të kryetarit të Bashkisë në foton e mbulimit është vendosur një foto me sloganin e Partisë Socialiste.






Handwritten marks or scribbles in the top left corner.

**Lidhja nr. 6** Postime të shpërnduara me përdorimin e hashtag-ëve sloganë elektoralë të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkive dhe Kryetarëve të Bashkive





***Lidhja nr. 6*** Postime të shogëruara me përdorimin e hashtag-eve sloganë elektorale të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkive dhe Kryetarëve të Bashkive

**6. Bashkia Gramsh - Kryetar Klodian Taje**

Në fagen zyrtare të Bashkisë Gramsh dhe Kryetarit të Bashkisë Gramsh është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhnjaJone ; #SkakohëPërPushim.







**Lidhja nr. 6**

**Postime të shpërnduara me përdorimin e hashtag-ëve sloganë elektorale të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkive dhe Kryetarëve të Bashkive**

Facebook post from the official page of the Socialists Party of the Municipality of Kavajë. The post features a 3x3 grid of images showing people in various settings, including a man in a suit and a group of people. The caption is in Albanian and mentions the party's slogan 'Kombi dhe Shkollat'.

Facebook post from the official page of the Socialists Party of the Municipality of Kavajë. The post features a 3x3 grid of images showing people in various settings, including a man in a suit and a group of people. The caption is in Albanian and mentions the party's slogan 'Kombi dhe Shkollat'.



7

**Lidhja nr. 6** Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-ëve sloganë elektoralë të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkiwe dhe Kryetarëve të Bashkiwe

**7. Bashkia Kavajë - Kryetar Redjan Kralli**

Në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë Kavajë është përdorur hashtag #SkakohëPërPushim #14maj.











Lidhja nr. 6 Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-ëve sloganë elektoralë të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkive dhe Kryetarëve të Bashkive

9. Bashkia Kolonje - Kryetar Erion Isai

Në faqen zyrtare të Bashkisë Kolonjë është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJone ; #SkakohëPërPushim.






10

Lidhja nr. 6 Postime të shodëruara me përdorimin e hashtag-eve sloganë elektorale të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkive dhe Kryetarëve të Bashkive

10. Bashkia Konispol – Kryetar Shuailp Beqiri

Në faqen zyrtare të Bashkisë Konispol është përdorur hashtag #SkakohëPërPushim.







Lidhja nr. 6 Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-ëve sloganë elektorale të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkiqe dhe Kryetarëve të Bashkiqe


**11. Bashkia Kukës - Kryetar Safet Gjiç**

Në faqen zyrtare të Bashkisë Kukës është përdorur hashtag #SkakohëPërPushim.





**Lidhja nr. 6** Postime të shogëruara me përdorimin e hashtag-ëve sloganë elektorale të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkiqe dhe Kryetarëve të Bashkiqe



1  
2  
3

13

Lidhja nr. 6 Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-eve sloganë elektorale të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkiave dhe Kryetarëve të Bashkiave

14. Bashkia Lushnje - Kryetare Eriselda Sefa

Në faqen zyrtare të Bashkisë Lushnje është përdorur hashtag #SkakohëPërPushim.

The image shows two screenshots of the official Facebook page of the Municipality of Lushnje. The top screenshot shows a post with the hashtag #SkakohëPërPushim and a photo of three people. The bottom screenshot shows another post with the same hashtag and a photo of a man in a cap. The page header includes the name 'Bashkia e Lushnjes' and the profile picture.





**Lidhja nr. 6** Postime të shogëruara me përdorimin e hashtag-ëve sloganë elektoralë të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkiwe dhe Kryetarëve të Bashkiwe

14

**17. Bashkia Prrrenjas - Kryetar Nuri Belba**

Në faqen zyrtare të Bashkisë Prrrenjas dhe të Kryetarit të Bashkisë është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkakohëPërPushim.





*Lidhja nr. 6* Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-ëve sloganë elektorale të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkive dhe Kryetarëve të Bashkive

12. Bashkia Lezhe - Kryetar Pjerin Ndreu

Në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë dhe të Kryetarit të Bashkisë është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkakohëPërPushim.







**Lidhja nr. 6** Postime të shpërnduara me përdorimin e hashtag-ëve sloganë elektorale të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkive dhe Kryetarëve të Bashkive






**Lidhja nr. 6** Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-eve sloganë elektoralë të Partisë Socialiste në Faget Zyrtare të Bashkiave dhe Kryetarëve të Bashkiave

**18. Bashkia Pustec- Kryetar Pali Kolefski**

Në fagen zyrtare të Bashkisë Pustec është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkakohëPërPushim.





Lidhja nr. 6 Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-eve sloganë elektoralë të Partisë Socialiste në Faget Zyrtare të Bashkiqe dhe Kryetarëve të Bashkiqe

20. Bashkia Shijak- Kryetar Elton Arbana

Në fagen zyrtare të Bashkisë Shijak është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkakohëPërPushim.

Bashkia Shijak

Prezantimi

Bashkia Shijak

- 📍 Faqe Shkollë
- 📍 Bashkia Shijak Albania
- 📞 069 920 0223
- 📧 info@shijak.gov.al
- 🌐 shijak.gov.al
- 🌐 shijak.gov.al

📌 Të gjithë shtetësit kërkohen të ndihmojnë 📌

Sajtjeto për informime

Fotografite

Shiko te gjitha fotografite



Bashkia Shijak



Eda Barina

📍 100m 1 vite nga shtetësit kërkohen të ndihmojnë 📍

📌 Të gjithë shtetësit kërkohen të ndihmojnë 📌





Lidhia nr. 6 Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-eve sloganë elektorale të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkive dhe Kryetarëve të Bashkive

21. Blerim Shera – Kryetar i Bashkisë Vorë

Në faqen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë në foton e mbulimit është vendosur një foto me sloganin e Partisë Socialiste.

*Per  
Socialiste*





19

**Lidhja nr. 6** Postime të shogëruara me përdorimin e hashtag-eve sloganë elektoralë të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkive dhe Kryetarëve të Bashkive

**19. Bashkia Roskovec- Kryetare Majlinda Bufi**


Në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec dhe të Kryetarës së Bashkisë është përdorur hashtag #ShqipëriaEArduhjaJonë ; #SkakohëPërPushim.







**Lidhja nr. 6** Postime të shogëruara me përdorimin e hashtag-ëve sloganë elektoralë të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkive dhe Kryetarëve të Bashkive





**Lidhia nr. 6** Postime të shogëruara me përdorimin e hashtag-eve sloganë elektoralë të Partisë Socialiste në Faget Zyrtare të Bashkive dhe Kryetarëve të Bashkive

5


**15. Bashkia Mallakastër - Kryetar Qerim Ismailaj**

Në fagen zyrtare të Bashkisë Mallakastër dhe të Kryetarit të Bashkisë është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkakohëPëPushim. Në fagen zyrtare të Kryetarit të Bashkisë në foton e mbulimit është vendosur një foto me sloganin e Partisë Socialiste.





**Libhia nr. 6** Postime të shpërnduara me përdorimin e hashtag-ëve sloganë elektorale të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkive dhe Kryetarëve të Bashkive







13

**Lidhia nr. 6** Postime të shoqëruara me përdorimin e hashtag-eve sloganë elektorale të Partisë Socialiste në Faget Zyrtare të Bashkive dhe Kryetarëve të Bashkive

**13. Bashkia Librazhd - Kryetar Kastriot Gurra**

Në fagen zyrtare të Bashkisë Librazhd dhe të Kryetarit të Bashkisë është përdorur hashtag #ShqipëriaEArdhmjaJonë ; #SkakohëPërPushim.

The image contains four screenshots of social media posts:

- Top Left:** A post from the official page of the Librazhd Municipality (Bashkia Librazhd) dated 11/11/2023. It features a grid of photos showing people in various settings. The text below the photos is partially visible and appears to be a list of names or titles.
- Top Right:** A post from the official page of the Librazhd Municipality dated 11/11/2023. It features a grid of photos. The text below the photos is partially visible.
- Bottom Left:** A post from the official page of the Librazhd Municipality dated 11/11/2023. It features a grid of photos. The text below the photos is partially visible.
- Bottom Right:** A post from the official page of the Librazhd Municipality dated 11/11/2023. It features a grid of photos. The text below the photos is partially visible.



**Lidhia nr. 6** Postime të shogëruara me përdorimin e hashtag-eve sloganë elektorale të Partisë Socialiste në Faqet Zyrtare të Bashkive dhe Kryetarëve të Bashkive

**Keshillat Gore**

**Prezantimi**  
 Keshilli Gore i Bashkisë Mirditë i përbëhet nga 20 anëtarë.

- 1. Idriz Aliu bashkëshort
- 2. Bektash Dega bashkëshort bashkëshort
- 3. Gëzim Mehmeti bashkëshort
- 4. Saharudin Dega bashkëshort

**Fotografite** Shfaq 14 fotografi të fotografive



**Postimi** 1000

**Keshilli Gore i Bashkisë Mirditë**  
 Keshilli Gore i Bashkisë Mirditë i përbëhet nga 20 anëtarë. #PSMirdite



**Keshilli Gore i Bashkisë Mirditë**  
 Keshilli Gore i Bashkisë Mirditë i përbëhet nga 20 anëtarë. #PSMirdite

**Keshillat Gore**

**Prezantimi**  
 Keshilli Gore i Bashkisë Mirditë i përbëhet nga 20 anëtarë.

- 1. Idriz Aliu bashkëshort
- 2. Bektash Dega bashkëshort bashkëshort
- 3. Gëzim Mehmeti bashkëshort
- 4. Saharudin Dega bashkëshort

**Fotografite** Shfaq 14 fotografi të fotografive



**Postimi** 1000

**Keshilli Gore i Bashkisë Mirditë**  
 Keshilli Gore i Bashkisë Mirditë i përbëhet nga 20 anëtarë. #PSMirdite



**Keshilli Gore i Bashkisë Mirditë**  
 Keshilli Gore i Bashkisë Mirditë i përbëhet nga 20 anëtarë. #PSMirdite





Kërkesa nr. 20



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data 6.5.2023  
Nr. Prot 4733

**KËRKUES:** KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

**OBJEKTI:** Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ

**DREJTUAR:** KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur denoncimi me nr. 336 ID nëpërmjet shkresës së datës 17.04.2023, administruar me tonën me nr. 3964/1 prot., datë 19.4.2023, me denoncues Qendra "Qëndresa Qytetare". Pala denoncuese pretendon se ka patur përdorim të burimeve publike.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerëson se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të procedurës administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vijoi hetimin administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Denoncuesi pretendon se janë përdorur burime publike, referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, informacion sqarues në lidhje me shkaqet

dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se rasti objekt denoncimi regjistruar me nr. 335 ID përbën shkelje të nenit 91, të Kodit Zgjedhor.

Referuar nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet se, *"Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën veprë penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë"*.

Referuar nenit 171, pikë 2, të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet se, *"Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë veprë penale, dënohen me gjobë nga 1,000 deri në 2,500 lekë"*.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, si dhe në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, 91, 92, 171, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimin nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve", i propozoj Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, marrjen e masës administrative ndaj:

- z. Safet Gjici, Kryetar dhe njëkohësisht kandidatit për Bashkinë Kukës, gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
- z. Rustem Dervishi, Drejtori i Shkollës 9 - Vjeçare "Shaban Murati", gjobë në masën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë.

Nga të dhënat, rezulton se z. Safet Gjici është përsëritës për shkeljen.

Nga të dhënat, rezulton se z. Rustem Dervishi nuk është përsëritës për shkeljen.

Bashkëlidhur kërkesës për vendosje të sanksionit administrativ, ju vëmë në dispozicion, provat si më poshtë vijon:

- Vendimi nr. 440, datë 05.05.2023 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 336 ID të Organizatës "Qendresa Qytetare", ndaj kryetarit të bashkisë Kukës, drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, drejtorit të shkollës 9-vjeçare "Shaban Murati", Kukës dhe personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për shkelje administrative në kuadër të zgjedhjeve vendore të datës 14 Maj 2023;
- Denoncimi me nr. 336 ID, administruar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr. 3964/1 prot. , më datë 19.4.2023, me denoncues Qendra "Qëndresa Qytetare";

- E-mail nëpërmjet postes elektronike me titull “Kthim Përgjigje” më datë 23.4.2023, nga Bashkia Kukës;
- Provat link në rrjetin social Facebook:  
<https://www.facebook.com/watch/?v=1280338172556562>  
<https://www.facebook.com/safetgjici/videos/213193364676285>

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kopje: 3  
Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:  
E. Mema  
I. Horaalliu  
M. Koja  
A. Lamçe  
Y. Merkaç



**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**









QENDRESA  
QYTFETARE

336



Tiranë, më 18. 04. 2023

## KALLËZIM

### KALLËZUES:

**Qendra "Qëndresa Qytetare"**, një organizatë jofitimprurëse e regjistruar me Vendimin Nr. 1120, datë 15.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: Rruga "Ali Pashë Gucia", Pallati nr. 42 me adresë elektronike [qendresaqytetare@gmail.com](mailto:qendresaqytetare@gmail.com), me Drejtor Ekzekutiv **Z. Rigels Xhemollari**.

### KUNDËR:

**Z. Safet Gjici**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Kukës dhe kandidat i Partisë Socialiste për Bashkinë Kukës, me adresë: Sheshi "Skënderbej", Lagjja 5, Kukës.

**Z. Dëfrim Korbi**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Kukës, me adresë: Sheshi "Skënderbej", Lagjja 5, Kukës.

**Znj. Dallëndyshe Bici**, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me adresë: Rruga "Dora D'Istria", Tiranë.

**Dhe çdo personi tjetër, të pa identifikuar deri më tani nga ana jonë, por që me veprime konkrete rezulton se ka përgjegjësi administrative.**

### OBJEKTI:

1. Konstatimin e përdorimit të burimeve publike.
2. Konstatimin e shkeljes së detyrimit për të raportuar veprimtarinë publike.
3. Marrjen e sanksioneve administrative bazuar në dispozitat ligjore ndaj Z. Safet Gjici, Z. Dëfrim Korbi, Znj. Dallëndyshe Bici dhe ndaj çdo personi tjetër përgjegjës.

### DREJTUAR:

**Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**, me adresë: Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë, përfaqësuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**.

### BAZA LIGJORE:

Nenet 91, 92, 171 dhe 172, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "*Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë*";

Nenet 3, 4 dhe 10, të Vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9, datë 24.12.2020 "*Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve*".







**KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE**  
**ADRESIMI I DOKUMENTACIONIT HYRËS NË KQZ**

Drejtorise që i shkon  
dokumentacionit:

Veprimet e rekomanduara

Kabineti

SP

SAB

DPAZ

DAZ

DLD

DVJ

DSZMFM

DPRRESHM

DL

DKK

DMB

DBNJSHM

Përgjigje

Seancë publike

Ndjekje/ Raportim

Shqyrtim

Dijeni

Vlerësim

Rekomandime të tjera

Afati

ditë

KOMISIONERI  
Ilirjan Celibashi



## KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

I nderuar Z. Komisioner,

Pasi jemi njohur me aktivitetin e mëposhtëm të organizuar nga, paraqesim para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, këtë kallëzim kundër Z. Safet Gjici, Z. Dëfrim Korbi, Znj. Dallandyshe Bici dhe çdo personi tjetër, që gjatë hetimit administrativ do të rezultojë se ka përgjegjësi, për arsyet si më poshtë vijon:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES:

1. Më datë 16 prill 2023, në ambientet e jashtme të shkollës 9-vjeçare, Lusën, Ujmisht, është zhvilluar një takim mes kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Kukësit, njëherazi dhe kryetar aktual i kësaj Bashkie, Z. Safet Gjici dhe banorëve të fshatit [Prova nr. 1 – Fotografi të shkollës 9-vjeçare]. Siç rezulton nga pamjet filmike, Z. Gjici ka qenë i shoqëruar nga Znj. Dallëndyshe Bici, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës [Prova nr. 2 – Fotografi nga postimi i Z. Gjici].<sup>1</sup> Në ndërfaqen e raportimeve, nuk rezulton që aktiviteti në fjalë të jetë raportuar nga Bashkia e Kukësit [Prova nr. 3 – Ndërfaqja e raportimeve e Bashkisë Kukës]. Po ashtu, aktiviteti nuk rezulton të jetë raportuar as nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës [Prova nr. 4 – Ndërfaqja e raportimeve e Agjencisë Shtetërore e Kadastrës].

2. Gjatë këtij takimi, ndër të tjera, Dallëndyshe Bici, fjala e së cilës pasqyrohet në minutat 0:56-:2.10, të videos, të publikuar, shprehet: *"Jam këtu me bekimin e Kryeministrit për të qenë në krah të kandidaturës më të mirë për Kukësin. Duke qenë drejtoreshë për shumë vite në qeverinë shqiptare më është dhënë mundësia për të punuar edhe me kryetarë bashkie të djathtë, por me kryetar Safetin nuk më ka pushuar telefoni për hallet tuaja, për hallet e gjithësecilit."* Në vijim, ajo shprehet se: *"Nuk mund të kishte kandidaturë më të mirë për Kukësin sesa Safet Gjici. Të gjithë së bashku të kemi Z. Safet Gjicin të drejtojë bashkinë e Kukësit. Kjo është e mira e Kukësit, kjo është e mira juaj."*<sup>2</sup>

### II. E DREJTA E APLIKUESHME:

3. Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë":

- (i) Neni 91 "Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore" parashikon: *"1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të*

<sup>1</sup> Shih:

<https://www.facebook.com/safetgjici/posts/pfbid02hp3b72Uedm7EihygynLdY3t8n5c3oJv8JPN49FowZnq6Sksb5VFsZgBsDmDgAYZ9l>

<sup>2</sup> Shih: <https://www.facebook.com/safetgjici/videos/213193364676285>





kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. 2. Në kuptim të këtij neni, "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit."

- (ii) **Neni 92 "Veprimtaritë e institucioneve publike në fushatë"** parashikon: "1. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre. 2. Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv). Raportimi duhet të kryhet jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. 6. Mosraportimi i veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, ose zhvillimi i tyre, pavarësisht ndalimit nga KQZ-ja ngarkon me përgjegjësi personin përgjegjës, si dhe titullarin përkatës të institucionit kur ai ka penguar zbatimin e kësaj dispozite."
- (iii) **Neni 171 "Sanksionet administrative"** parashikon: "1. Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve osenga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohetme gjobë nga 3,000 deri në 90,000 lekë. 2. Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 1,000 deri në 2,500 lekë."
- (iv) **Neni 172 "Sanksionet për subjektin zgjedhor për shkelje të ndalimeve të këtij ligji"** parashikon: "1. Subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijani, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes. Kundërvajtja administrative sipas kësaj pike dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë."



4. Vendimi i Komisionit Rregullator nr. 9, datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve":

- (i) **Neni 3 "Veprimtari të ndaluara"** parashikon: "1. Në zbatim të këtij vendimi: 1.3 "veprimtari të ndaluara", janë edhe ato veprimtari që përfshijnë: c) vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njësisve të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit".
- (ii) **Neni 10 "Sanksionet administrative"** parashikon: "1. Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me gjobë nga 3000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar. 2. Në rast se Komisioneri konstaton se Titullari i institucionit ka penguar raportimin sipas këtij vendimi, ka ndikuar apo urdhëruar që ai të raportohet me vonesë, apo veprimtaria apo aktiviteti publik është zhvilluar pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, titullari i institucionit ndëshkohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë sipas nenit 169, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar."

### III. ANALIZA LIGJORE:

A. Në lidhje me përdorimin e burimeve publike:

5. Nga interpretimi sistematik i dispozitave të Kodit Zgjedhor me ato të vendimit nr. 9, të Komisionit Rregullator, që të ndodhemi përballë një shkeljeje administrative që lidhet me (keq)përdorimin e burimeve shtetërore, duhet që të plotësohen disa kushte në mënyrë kumulative. Së pari, duhet që veprimtaria të jetë kryer nga një prej subjekteve të ngarkuar me detyrime nga ligji dhe aktet nënligjore. Së dyti, duhet që veprimtaria të përfshijë vënien në dispozicion të aseteve



të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të Kodit Civil, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike. Dhe së treti, duhet që vënia në dispozicion e aseteve publike të jetë bërë për qëllime zgjedhore.

6. *Përsa i takon kushtit të lidhur me subjektet, ligjvënësi në pikën 1, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor bën një përcaktim të përgjithshëm duke sanksionuar se me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, burimet publike nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje.*

6.1 Në rastin konkret, Z. Safet Gjici është kandidat i Partisë Socialiste për kryetar në Bashkinë e Kukës dhe Partia Socialiste është një nga subjektet zgjedhore, të regjistruara në zgjedhjet e 14 majit 2023. Dhe për rrjedhojë, ky kusht i parë në lidhje me subjektin ndaj të cilit duhet të jenë vënë në mbështetje dhe prej të cilit janë përdorur burimet, plotësohet në rastin konkret.

7. *Përsa i takon kushtit të dytë të lidhur me vënien në dispozicion të burimeve publike, duhet që burimet të jenë asete të luajtshme ose të paluajtshme në pronësi të organeve publike qendrore ose të njësisve të vetëqeverisjes vendore. Në referim të nenit 142, të Kodit Civil, sende të paluajtshme janë toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat, ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën, kurse të gjitha sendet e tjera, përfshirë dhe çdo energji tjetër natyrore, janë sende të luajtshme.*

7.1 Siç rezulton edhe nga rrethanat e çështjes, veprimtaria publike është zhvilluar në ambientet e oborrit të shkollës 9-vjeçare “Shaban Murati”, Lusën, Ujmisht. Përsa më sipër, në rastin konkret, provohet tërësisht përmbushja e këtij kushti të dytë.

8. *Përsa i takon kushtit të tretë që lidhet me qëllimin e vënies në dispozicion të aseteve publike, referuar pikës 2, të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, për efekt të ngarkimit me përgjegjësi administrative duhet që vënia në dispozicion e aseteve shtetërore e publike të jetë bërë për qëllime zgjedhore.*

9. Në rastin konkret, është e qartë që vënia në dispozicion e aseteve shtetërore është bërë për qëllime zgjedhore. Kjo vërehet, së pari, nga vendosja e banderolave dhe materialeve të tjera propaganduese të Partisë Socialiste, duke përfshirë dhe sloganin “Kurrë më mbrapa, vetëm përpara”. Njëherazi, edhe deklaratimet e Znj. Bici, e cila shprehet se: *“Jam këtu me bekimin e Kryeministrit për të qenë në krah të kandidaturës më të mirë për Kukësin. Duke qenë drejtoreshë për shumë vite në qeverinë shqiptare më është dhënë mundësia për të punuar edhe me kryetarë bashkie të djathtë, por me kryetar Safetin nuk më ka pushuar telefoni për hallet tuaja, për hallet e gjithësecilit.”*





10. Gjithashtu, në referim të pikës 2, të nenit 3, të vendimit nr. 9/2020, mbi një kategori të caktuar të funksionarëve publikë rëndon detyrimi që gjatë periudhës kohore katër mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdo forme, në veprimtari të ndaluara. Në këtë kategori të funksionarëve publikë bëjnë pjesë dhe drejtorët e përgjithshëm të agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrit. Në referim të nenit 6, të nenit 118/2020 “Për kadastrën”, Agjencia Shtetërore e Kadastrës është person juridik publik në varësi të Kryeministrit. Dhe për rrjedhojë, Drejtori i Përgjithshëm i Kadastrës, Znj. Dallëndyshe Bici ndalohet të marrë pjesë në të tilla aktivitete të ndaluara. Në të tilla kushte, përveç Z. Gjici dhe Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare të fshatit Fshat dhe personave të tjerë përgjegjës, Znj. Bici është përgjegjëse për shkeljen e kryer dhe duhet ndëshkuar me gjobë.

*B. Në lidhje me shkeljen e detyrimit për raportimin e veprimtarisë publike:*

11. Referuar pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, institucionet publike, qendrore dhe vendore, janë të detyruara të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Në zbatim të pikës 2, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor dhe pikës 3, të nenit 4, të Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, raportimi në ndërfaqe duhet të kryhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara datës në të cilën planifikohet të zhvillohet. Në të kundërt, nëse veprimtaria publike nuk raportohet apo raportohet në tejkalim të këtij afati, do të ndodhemi përballë një shkeljeje administrative, e cila, në referim të pikës 6, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, e ngarkon personin përgjegjës për raportim me përgjegjësi administrative.

12. Sipas pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, veprimtari publike formojnë të gjitha ato veprimtari që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, Nga leximi i kësaj dispozite, rezulton se ndodhemi përballë detyrimit për raportim të një aktiviteti publik vetëm nëse plotësohen kushtet, të cilat për efekt të analizës së ligjit, duhet t’i ndajmë në kushte që lidhen me: (i) natyrën e veprimtarisë; (ii) subjektet që duhet ta kryejnë këtë veprimtari dhe (iii) afatin kohor brenda të të cilit ekziston detyrimi për raportim.

13. *Përsa u takon kushteve që lidhen me natyrën e veprimtarisë*, vlen të theksojmë se detyrimi për raportim ekziston për të gjitha ato veprimtari që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin. Pra për t’u ndodhur përballë detyrimit për të raportuar një aktivitet, ky i fundit duhet të: (i) ose të jetë i hapur për pjesëmarrjen e publikut apo medias; (ii) ose të ketë si agjendë të tij informimin. Sipas praktikës së Komisionit të Ankimit dhe Sanksioneve, më konkretisht në referim të vendimit nr. 19, datë 31.05.2022 dhe vendimit nr. 23, datë 14.09.2022, që veprimtaria të quhet publike, sipas kuptimit të kësaj dispozite, ajo nuk duhet domosdoshmërisht të jetë miting, tubim, mbledhje apo grumbullim i thirrur dhe i organizuar me synim pjesëmarrjen e publikut. Mjafton që ajo të jetë e “hapur”, domethënë të mos



zhvillohet “pas dyerve të mbyllura”. Nuk ka nevojë që publiku apo media të thirren, të ftohen apo të mobilizohen për të marrë pjesë në veprimtari që ajo të quhet publike. Mjafton që ata të kenë akses dhe të mos ndalohen kur i qasen asaj. Nga ana tjetër, veprimtaria bëhet publike sipas kuptimit të kësaj dispozite, edhe në rastet kur ajo zhvillohet “pas dyerve të mbyllura”, por ama synon dhe realizon në fakt informimin e publikut për temat, diskutimet dhe përfundimet e agjendës së saj.

14. Në rastin konkret, siç vërtetohet dhe nga rrethanat e faktit, verifikohet ekzistenca e këtij kushti. Kjo pasi takimi ka qenë i hapur për publikun dhe është pasqyruar gjerësisht në rrjetet sociale.

15. *Përsa u takon subjekteve që duhet ta kryejnë veprimtarinë publike mbi të cilën rëndon detyrimi për raportim*, në referim të pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, përcaktohet se detyrimi për raportim ekziston mbi institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore. Në rastin konkret, mbi veprimtarinë në fjalë ka rënduar detyrimi për raportim dhe për rrjedhojë, edhe kushti i dytë plotësohet.

16. *Përsa i takon afatit kohor për veprimtaritë publike, të cilat duhet të raportohen*, në referim të fjalisë së dytë, të pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, detyrimi për raportim ekziston për të gjithë ato veprimtari publike që bëhen brenda një periudhe 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve. Për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, periudha 4 (katër) mujore, brenda të cilës ekziston detyrimi për raportim i aktiviteteve publike, ka filluar më datë 13 janar 2023. Ndërkohë që, veprimtaria publike në ambientet e shkollës 9-vjeçare është zhvilluar brenda kësaj periudhe. Megjithë këtë detyrim ligjor që buron për institucionin përgjegjës për të raportuar aktivitetin në fjalë, siç rezulton nga provat bashkëlidhur këtij kallëzimi, Z. Korbi, në cilësinë e personit të ngarkuar me detyrimin për raportim nuk ka ndërmarrë asnjë masë për raportimin e këtij aktiviteti në ndërfaqen e krijuar dhe administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe për rrjedhojë, subjekti përgjegjës duhet sanksionuar administrativisht sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe të Vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9/2020.

#### **IV. KONKLUZIONE:**

17. Përsa më lart, mbështetur në nenin pikën 1 dhe 2, të nenit 91, në pikën 1, të nenit 171 dhe në pikën 1, të nenit 172, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë; pikën 1 dhe 2, të nenit 3 dhe pikën 1, të nenit 10, të Vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9/2020, përfundimisht,

#### **KËRKOJMË:**

1. Konstatimin e përdorimit të burimeve publike.
2. Konstatimin e shkeljes së detyrimit për të raportuar veprimtarinë publike.



3. Marrjen e sanksioneve administrative bazuar në dispozitat ligjore ndaj Z. Safet Gjici, Z. Dëfrim Korbi, Znj. Dallëndyshe Bici dhe ndaj çdo personi tjetër përgjegjës.

Për "QËNDRESA QYTETARE"



**Bashkëlidhur mund të gjeni:**

- Prova nr. 1 – Fotografi të shkollës 9-vjeçare;
- Prova nr. 2 – Fotografi nga postimi i Z. Gjici;
- Prova nr. 3 – Ndërfaqja e raportimeve e Bashkisë Kukës;
- Prova nr. 4 – Ndërfaqja e raportimeve e Agjencisë Shtetërore e Kadastrës.









Inspektimi ne Tejedertine, Njësia Ujmisht Bashkia Kule | 24/03/23 | Aktivitetet e raportuara

Inspektimi për të parë punimet e rrugës Lloji | Aktivitetit: Inspektimi/kontrolli Data: 30/03/2023 Ora: 10:00 Vendi i Zhvillimit: Tejedertine, Ujmisht Shteti: Shqipëri Qarku: Kules Bashkia: Kules Njësia Administrative: Ujmisht Folesit Kryesore: Safet Gjici/Posicioni...

Inspektimi në lagjen e Re Bashkia Kule | 24/03/23 | Aktivitetet e raportuara

Inspektimi për të parë sigurinë e punimeve në hapjen e kanalizimeve Lloji | Aktivitetit: Inspektimi/kontrolli Data: 29/03/2023 Ora: 10:00 Vendi i Zhvillimit: Lagje e Re Shteti: Shqipëri Qarku: Kules Bashkia: Kules Njësia Administrative: Kules Folesit Kryesore: Safet...

<b>Akses i Lehtësuar</b>	<b>Legjislacioni</b>	<b>Transparenca</b>	<b>Kryetari Social</b>





Informacion rreth ecuris se regjistrimit fillestar në Jug  
Agjenda Shiterore e Kadastres | 28/02/23 | Aktivitetet e raportuara

Kronik ne TV Klan na lidhje me ecurin e regjistrimit fillestar të pronave në Jug të vendit. Lloji i Aktivitetit: Tjetër Tjetër- Kronik ne TV Data:: 04.02.2023 Ora:: 10:00 Vendi i Zhvillimit: Televizioni Klan Shteti: Shqipëri Qarku: Vlorë Bashkia: Himarë/nare Njësia...

Raportim mbi Indikatoret e Performances per ASHK 2006 – 2022  
Agjenda Shiterore e Kadastres | 14/02/23 | Aktivitetet e raportuara

Diskutim me gazetarët në lidhje me ecurinë e punës së Kadastres për vitin 2022 Lloji i Aktivitetit: Aktivitet ndërgjegjesues/informues Data:: 17/02/2023 Ora:: 10:00 Vendi i Zhvillimit: Ambientet e drejtorisë qendrore të Kadastres Shqipëtare Shteti: Shqipëri Qarku...

**Akses i Lehtësuar**

- 🔍 🔍
- 📄 📄
- 🗂 🗂
- 📄 📄
- 🗂 🗂
- 📄 📄
- 🗂 🗂



**Transparenca**


- Koordinatori
- Programi
- Modelet
- Informacione

**Rrjetet Sociale**

- 📄
- 🗂
- 📄
- 🗂







This photo is from a post

View po



Shkolla Lusen

November 28, 2017

17

1

Like

Comment


Share



Write a comment...



























**Kerkese per informacion (336), kthim pergjigje .**

ZVA Kukes <ZVAKukes@arsimi.gov.al>

Fri 4/28/2023 9:09 AM

To: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Drejtori i shkolles Lusën , Rustem Bajram Dervishi i dtl 10.10.1968

Pune te mbare !

---

**From:** denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

**Sent:** Thursday, April 27, 2023 3:53 PM

**To:** ZVA Kukes <ZVAKukes@arsimi.gov.al>

**Subject:** Fw: Kerkese per informacion (336), kthim pergjigje .

Pershendetje,

Kerkojme nga ana juaj te na beni te ditur, emrin e drejtuesit te shkolles 9 vjecare Lusën.

Faleminderit.

---

**From:** ZVA Kukes <ZVAKukes@arsimi.gov.al>

**Sent:** Thursday, April 27, 2023 11:58 AM

**To:** denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

**Subject:** Kerkese per informacion (336), kthim pergjigje .

Pershendetje,

Bazuar ne ankesen e paraqitur prane jush ne lidhje me takimin e zhvilluar ne ambientet e shkolles 9-vjecare Lusën , ju bejme me dije se Zyra e Arsimit Parauniversitar Kukes , nuk eshte ne dijeni te zhvillimit te ketij takimi. Pas komunikimit me drejtorin e shkolles , ai na komunikon se nuk ka dijeni per zhvillimin e ketij takimi , dhe prane kesaj shkolle nuk eshte zhvilluar asnje takim politik .

Mbetemi ne kontakt per venien ne dispozicion te cdo informacioni qe ZVAP disponon ,

Pune te mbare !

---

**From:** denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

**Sent:** Wednesday, April 26, 2023 2:58 PM

**To:** ZVA Kukes <ZVAKukes@arsimi.gov.al>

**Subject:** Fw: Kerkese per informacion (336)

Pershendetje,



## Kerkese per informacion (336)

denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Thu 4/20/2023 3:36 PM

To: Ledia Lila <ledia.lila@ashk.gov.al>; Defrim Korbi <defrim.korbi@gmail.com>

Cc: Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com>

Bcc: Ylli Merkaj <Ylli.Merkaj@kqz.gov.al>; Aurel Lamce <Aurel.Lamce@kqz.gov.al>; Madalena Koja <Madalena.Koja@kqz.gov.al>

Pershendetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 3946, datë 19.04.2023, është adm inistruar denoncimi i përcjellë nga Organizata "Qëndresa Qytetare" nëpërmjet së cilit pretendohet si vijon:

*" Më datë 16 prill 2023, në ambientet e jashtme të shkollës 9-vjeçare, Lusën, Ujmisht, është zhvilluar një takim mes kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Kukësit, njëherazi dhe kryetar aktual i kësaj Bashkie, Z. Safet Gjici dhe banorëve të fshatit. Siç rezulton nga pamjet filmike, Z. Gjici ka qenë i shoqëruar nga Znj. Dallëndyshe Bici, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në ndërfaqen e raportimeve, nuk rezulton që aktiviteti në fjalë të jetë raportuar nga Bashkia e Kukësit. Po ashtu, aktiviteti nuk rezulton të jetë raportuar as nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Gjatë këtij takimi, ndër të tjera, Dallëndyshe Bici, fjala e së cilës pasqyrohet në minutat 0:56-:2.10, të videos, të publikuar, shprehet: "Jam këtu me bekimin e Kryeministrit për të qenë në krah të kandidaturës më të mirë për Kukësin. Duke qenë drejtoreshë për shumë vite në qeverinë shqiptare më është dhënë mundësia për të punuar edhe me kryetarë bashkie të djathtë, por me kryetar Safetin nuk më ka pushuar telefoni për hallet tuaja, për hallet e gjithsecilit." Në vijim, ajo shprehet se: "Nuk mund të kishte kandidaturë më të mirë për Kukësin sesa Safet Gjici. Të gjithë së bashku të kemi Z. Safet Gjicin të drejtojnë bashkinë e Kukësit. Kjo është e mira e Kukësit, kjo është e mira juaj".*

Per sa me siper kerkojme informacion te detajuar nga ana juaj ne lidhje me denoncimin e pretenduar nga deoncuesi, arsyen e mosraportimit te veprimtarise publike, si dhe arsyen e shperdorimit te burimeve publike.

Pretendimet tuaja duhet te percillen prane Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni e këtij email-i.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 278 Prot.

Tiranë, më 26.04.2023

**Lënda:** Shpjgime para Komisionerit Shtetror të Zgjedhjeve, Mbi hetimet administrative te nisura nga organizata "Qendresa Qytetare" pranë Komisionit Qendror Zgjedhor.

**KOMISIONERI SHTETROR I ZGJEDHJEVE**

**Baza Ligjore:** Neni 47 dhe 87 I Kodit të Procedurës Civile

Ligji 10019, datë 29.12.2008

Vendimi Nr.9, datë 24.12.2020 i Komisionit Qendror Zgjedhor

Të nderuar,

Dëshiroj tju informojmë se ne lidhje me pretendimin e organizatës "Qëndresa Qytetare", mbi mos raportimin takimeve, që janë zhvilluar me datë 16 prill 2023 mes kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Kukësit, njëherazi dhe kryetar aktual i kësaj Bashkie, z. Safet Gjici dhe banorëve të fshatrave Ujmisht dhe Fshat, të Njesisë Administrative Grykë-Çajë, bashkia Kukës. Sqarojmë se sipas pikës 2, të Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 i Komisionit Qendror Zgjedhor se një veprimtari është publike kur ajo pasqyrohet sipas rastit në radio, në televizion, në shtyp, në faqe interneti, në median online, në rrjetet sociale, ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër që mundëson publikun e gjërë të njihet, apo informohet mbi atë veprimtari. Në rastin konkret nga institucioni ynë nuk është organizuar asnjë veprimtari Publike. Pasi prezenca zj. Dallëndyshe Bici, në këtë takim nuk lidhet me detyrën e saj funksionale si Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetore të Kadastrës, por si një vizitë e saj pranë miqve dhe familjarëve në vendin e origjinës jashtë orarit zyrtar të punës, e cila ka përkuar me ditën e organizimit të këtij takimi.

Për më tepër nuk është kryer asnjë shkelje pasi në këtë takim rastësor nuk është bërë shpërndarje apo premtim publik për leje legalizimi apo çdo lloj titulli pronësie. Parashikuar sipas nenit 11 Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 i Komisionit Qendror Zgjedhor.

Në këto kushte arsyetojmë se denoncimit të organizatës "Qendresa Qytetare" i është bërë në interpretim të gabuar të ligjit.

Duke Ju falenderuar

**PERSONI RAPORTUES PRANË KQZ  
PËR AGJECINË SHTETRORE TË KADASTRËS**

**Ledia Lila**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 278 Prot.

Tiranë, më 26.04.2023

**Lënda:** Shpjgime para Komisionerit Shtetror të Zgjedhjeve, Mbi hetimet administrative te nisura nga organizata "Qendresa Qytetare" pranë Komisionit Qendror Zgjedhor.

**KOMISIONERI SHTETROR I ZGJEDHJEVE**

**Baza Ligjore:** Neni 47 dhe 87 I Kodit të Procedurës Civile

Ligji 10019, datë 29.12.2008

Vendimi Nr.9, datë 24.12.2020 i Komisionit Qendror Zgjedhor

Të nderuar,

Dëshiroj tju informojmë se ne lidhje me pretendimin e organizatës "Qendresa Qytetare", mbi mos raportimin takimeve, që janë zhvilluar me datë 16 prill 2023 mes kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Kukësit, njëherazi dhe kryetar aktual i kësaj Bashkie, z. Safet Gjici dhe banorëve të fshatrave Ujmisht dhe Fshat, të Njësisë Administrative Grykë-Çajë, bashkia Kukës. Sqarojmë se sipas pikës 2, të Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 i Komisionit Qendror Zgjedhor se një veprimtari është publike kur ajo pasqyrohet sipas rastit në radio, në televizion, në shtyp, në faqe interneti, në median online, në rrjetet sociale, ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër që mundëson publikun e gjërë të njihet, apo informohet mbi atë veprimtari. Në rastin konkret nga institucioni ynë nuk është organizuar asnjë veprimtari Publike. Pasi prezenca zj. Dallëndyshe Bici, në këtë takim nuk lidhet me detyrën e saj funksionale si Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetore të Kadastrës, por si një vizitë e saj pranë miqve dhe familjarëve në vendin e origjinës jashtë orarit zyrtar të punës, e cila ka përkuar me ditën e organizimit të këtij takimi.

Për më tepër nuk është kryer asnjë shkelje pasi në këtë takim rastësor nuk është bërë shpërndarje apo premtim publik për leje legalizimi apo çdo lloj titulli pronësie. Parashikuar sipas nenit 11 Vendimit Nr.9, datë 24.12.2020 i Komisionit Qendror Zgjedhor.

Në këto kushte arsyetojmë se denoncimit të organizatës "Qendresa Qytetare" i është bërë në interpretim të gabuar të ligjit.

Duke Ju falenderuar

**PERSONI RAPORTUES PRANË KQZ  
PËR AGJECINË SHTETRORE TË KADASTRËS**

Ledia Lila





**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Kërkesa nr. 19

Data 6.5.2023  
Nr. Prot 4732

**KËRKUES:** KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

**OBJEKTI:** Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ

**DREJTUAR:** KOMISIONIT TË ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur denoncimi me nr. 335 ID, nëpërmjet shkresës së datës 17.04.2023, administruar me tonën me nr. 3964 prot., datë 19.4.2023, me denoncues Qendra "Qëndresa Qytetare". Pala denoncuese pretendon se ka patur përdorim të burimeve publike.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerëson se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të procedurës administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vijoi hetimin administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Denoncuesi pretendon se nëpërmjet kryerjes së aktivitetit të mësipërm janë përdorur burime publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore, referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike



nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se rasti objekt denoncimi regjistruar me nr. 335 ID përbën shkelje të nenit 91, të Kodit Zgjedhor.

Referuar nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet se, *“Shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë”*.

Referuar nenit 171, pikë 2, të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet se, *“Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 1,000 deri në 2,500 lekë”*.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, si dhe në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 91, 92, 171, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimin nr. 9, datë 09.03.2021 të Komisionit Rregullator”, i propozoj Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, marrjen e masës administrative ndaj:

- z. Safet Gjici, Kryetar dhe njëkohësisht kandidatit për Bashkinë Kukës, gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
- z. Betim Lushi, Drejtori i Shkollës 9- Vjeçare “Isuf Seferi”, gjobë në masën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë.

Nga të dhënat, rezulton se z. Safet Gjici, nuk është përsëritës për shkeljen.

Nga të dhënat, rezulton se z. Betim Lushi, nuk është përsëritës për shkeljen.

Bashkëlidhur kërkesës për vendosje të sanksionit administrativ, ju vëmë në dispozicion, provat si më poshtë vijon:

- Vendimi nr. 439, datë 05.05.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 335 ID të Organizatës “Qendresa Qytetare”, ndaj kryetarit të bashkisë Kukës, drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Isuf Seferi”, Kukës dhe personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për shkelje administrative në kuadër të zgjedhjeve vendore të datës 14 Maj 2023;
- Denoncimi administruar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr. 3946 prot. , më datë 19.4.2023;
- E-mail nëpërmjet postës elektronike me titull “Kthim Përgjigje” më datë 23.4.2023, nga Bashkia Kukës;



- Provat link në rrjetin social Facebook:  
<https://www.facebook.com/watch/?v=1280338172556562>  
<https://www.facebook.com/safetgjici/videos/213193364676285>

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kopje: 3

Afati i rrujtjes: 5 vjet

Punoit:

E. Memu

I. Hoxanlliu

M. Kaja

A. Lamçe

Y. Merkaç



**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**





## Kthim Pergjigje

Bashkia Kukës <info@kukesi.gov.al>

Sun 4/23/2023 4:15 PM

To: denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Cc: Defrim Korbi <defrim.korbi@gmail.com>

Përshendetje,

Në përgjigje të shkresës Nr.3946 date 19.04.2023 të KQZ,

Nisur nga denocimi i bërë nga Organizata "Qendresa Qytetare" raportuar pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, në lidhje me dy veprimtari në fshatin Fshat dhe fshatin Lusën, të publikuar më datë 16 Prill 2023, në faqen zyrtare të kryetarit/kandidatit z. Safet Gjici, ju bëjmë me dije se:

Aktiviteti i publikuar në ndërfaqen e kryetarit/kandidatit, është aktivitet politik i organizuar nga subjekti partiak, në të cilën kandidon kandidati.

Kryetari/kandidati në këtë rast ka ndjekur axhendën e tij si kandidat dhe figurë politike. Si e tillë kjo axhendë nuk përfshihet në raportimet e aktivitetit të bashkisë (nuk janë aktivitete të organizuara nga Bashkia Kukës), sipas Kodit Zgjedhor.

Theksojmë se: subjekti partiak është oragnizatori i takimeve që kryetari/kandidati merr pjesë si figure politike dhe ndjek axhendën që subjekti organizon.

--



**Bashkia Kukës**

---

Adresa: Sheshi "Skënderbej" Kukës, Lagjia 5, 8501

Web: [www.kukesi.gov.al](http://www.kukesi.gov.al)

Tel: (024) 225-110





QENDRESA  
QYTETARE

335



Tiranë, më 17. 04. 2023

## KALLËZIM

### KALLËZUES:

Qendra "Qëndresa Qytetare", një organizatë jofitimprurëse e regjistruar me Vendimin Nr. 1120, datë 15.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: Rruga "Ali Pashë Gucia", Pallati nr. 42 me adresë elektronike [qendresaqytetare@gmail.com](mailto:qendresaqytetare@gmail.com), me Drejtor Ekzekutiv **Z. Rigels Xhemollari**.

### KUNDËR:

**Z. Safet Gjici**, me detyrë Kryetar i Bashkisë Kukës dhe kandidat i Partisë Socialiste për Bashkinë Kukës, me adresë: Sheshi "Skënderbej", Lagjia 5, Kukës.

**Z. Dëfrim Korbi**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Kukës, me adresë: Sheshi "Skënderbej", Lagjia 5, Kukës.

**Znj. Dallëndyshe Bici**, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me adresë: Rruga "Dora D'Istria", Tiranë.

**Dhe çdo personi tjetër, të pa identifikuar deri më tani nga ana jonë, por që me veprime konkrete rezultojnë se ka përgjegjësi administrative.**

### OBJEKTI:

1. Konstatimin e përdorimit të burimeve publike.
2. Konstatimin e shkeljes së detyrimit për të raportuar veprimtarinë publike.
3. Marrjen e sanksioneve administrative bazuar në dispozitat ligjore ndaj Z. Safet Gjici, Z. Dëfrim Korbi, Znj. Dallëndyshe Bici dhe ndaj çdo personi tjetër përgjegjës.

### DREJTUAR:

**Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**, me adresë: Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë, përfaqësuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**.

### BAZA LIGJORE:

Nenet 91, 92, 171 dhe 172, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "*Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë*";  
Nenet 3, 4 dhe 10, të Vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9, datë 24.12.2020 "*Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve*".

---







**KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE**  
**ADRESIMI I DOKUMENTACIONIT HYRËS NË KQZ**

Drejtoria që i shkon dokumentacioni:

- Kabineti
- SP
- SAB
- DPAZ
- DAZ
- DLD
- DVJ
- DSZMFM
- DPRRESHM
- DL
- DKK
- DMB
- DBNJSHM

Veprimet e rekomanduara

<b>Përgjigje</b>	<input type="checkbox"/>
<b>Seancë publike</b>	<input checked="" type="checkbox"/>
<b>Ndjekje/ Raportim</b>	<input type="checkbox"/>
<b>Shqyrtim</b>	<input checked="" type="checkbox"/>
<b>Dijeni</b>	<input type="checkbox"/>
<b>Vlerësim</b>	<input checked="" type="checkbox"/>

<b>Rekomandime të tjera</b>

Afati	<input type="text"/>	ditë
-------	----------------------	------

KOMISIONERI  
Ilirjan Celibashi



## KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

I nderuar Z. Komisioner,

Pasi jemi njohur me aktivitetin e mëposhtëm të organizuar nga, paraqesim para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, këtë kallëzim kundër Z. Safet Gjici, Z. Dëfrim Korbi, Znj. Dallandyshe Bici dhe çdo personi tjetër, që gjatë hetimit administrativ do të rezultojë se ka përgjegjësi, për arsyet si më poshtë vijon:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES:

1. Më datë 16 prill 2023, në ambientet e oborrit të shkollës 9-vjeçare "Isuf Seferi" në fshatin Fshat, të Njësisë Administrative Grykë-Çajë, është zhvilluar një takim mes kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Kukësit, njëherazi dhe kryetar aktual i kësaj Bashkie, Z. Safet Gjici dhe banorëve të fshatit Fshat, të Njësisë Administrative [Prova nr. 1 – Fotografi të shkëputura nga postimi i Z. Gjici].<sup>1</sup> Siç rezulton nga pamjet filmike, Z. Gjici ka qenë i shoqëruar nga Znj. Dallëndyshe Bici, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në ndërfaqen e raportimeve, nuk rezulton që aktiviteti në fjalë të jetë raportuar nga Bashkia e Kukësit [Prova nr. 2 – Ndërfaqja e raportimeve e Bashkisë Kukës]. Po ashtu, aktiviteti nuk rezulton të jetë raportuar as nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës [Prova nr. 3 – Ndërfaqja e raportimeve e Agjencisë Shtetërore e Kadastrës].

2. Gjatë këtij takimi, ndër të tjera, Dallandyshe Bici, fjala e së cilës pasqyrohet në minutat 1:23-2:17, të videos, të publikuar, shprehet: *"Kështu në qoftë se votat tuaja do jenë për Partinë Socialiste dhe për kryetarin e palodhur, Safetin, edhe investimet do të jenë më të mëdhaja. Prandaj të gjithë bashkë të punojmë, t'i japim krahun njeriut të punës, t'i japim krahun njeriut më të mirë, jo për të fituar, se është e sigurt, por për të patur një fitore të sigurt"*.<sup>2</sup>

### II. E DREJTA E APLIKUESHME:

3. Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë":

- (i) Neni 91 "Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore" parashikon: *"1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti*

<sup>1</sup> Shih:

<https://www.facebook.com/safetgjici/posts/pfbid02hp3b72Uedm7EihygnLdY3t8n5c3oJv8JPN49FowZnq6Sksb5VFsZgBsDmDgAYZ9l>

<sup>2</sup> Shih: <https://www.facebook.com/watch/?v=1280338172556562>





tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia. 2. Në kuptim të këtij neni, "burime" quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit."

- (ii) **Neni 92 "Veprimtaritë e institucioneve publike në fushatë"** parashikon: "1. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre. 2. Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv). Raportimi duhet të kryhet jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. 6. Mosraportimi i veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, ose zhvillimi i tyre, pavarësisht ndalimit nga KQZ-ja ngarkon me përgjegjësi personin përgjegjës, si dhe titullarin përkatës të institucionit kur ai ka penguar zbatimin e kësaj dispozite."
- (iii) **Neni 171 "Sanksionet administrative"** parashikon: "1. Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve osenga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohetme gjobë nga 3,000 deri në 90,000 lekë. 2. Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 1,000 deri në 2,500 lekë."
- (iv) **Neni 172 "Sanksionet për subjektin zgjedhor për shkelje të ndalimeve të këtij ligji"** parashikon: "1. Subjektet zgjedhore kryejnë kundërvajtje administrative në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji dhe subjektet zgjedhore, pas marrjes dijani, nuk marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes. Kundërvajtja administrative sipas kësaj pike dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë."

4. Vendimi i Komisionit Rregullator nr. 9, datë 24.12.2020 "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe



monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”:

- (i) **Neni 3 “Veprimtari të ndaluara”** parashikon: “1. Në zbatim të këtij vendimi: 1.3 “veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë: c) vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njërive të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit”.
- (ii) **Neni 10 “Sanksionet administrative”** parashikon: “1. Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën vepër penale, dënohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me gjobë nga 3000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. 2. Në rast se Komisioneri konstaton se Titullari i institucionit ka penguar raportimin sipas këtij vendimi, ka ndikuar apo urdhëruar që ai të raportohet me vonesë, apo veprimtaria apo aktiviteti publik është zhvilluar pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, titullari i institucionit ndëshkohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë sipas nenit 169, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.”

### III. ANALIZA LIGJORE:

#### A. Në lidhje me përdorimin e burimeve publike:

5. Nga interpretimi sistematik i dispozitave të Kodit Zgjedhor me ato të vendimit nr. 9, të Komisionit Rregullator, që të ndodhemi përballë një shkeljeje administrative që lidhet me (keq)përdorimin e burimeve shtetërore, duhet që të plotësohen disa kushte në mënyrë kumulative. Së pari, duhet që veprimtaria të jetë kryer nga një prej subjekteve të ngarkuar me detyrime nga ligji dhe aktet nënligjore. Së dyti, duhet që veprimtaria të përfshijë vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të Kodit Civil, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike. Dhe së treti, duhet që vënia në dispozicion e aseteve publike të jetë bërë për qëllime zgjedhore.



6. *Përsa i takon kushtit të lidhur me subjektet, ligjvënësi në pikën 1, të nenit 91, të Kodit Zgjedhor bën një përcaktim të përgjithshëm duke sanksionuar se me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, burimet publike nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje.*

6.1 Në rastin konkret, Z. Safet Gjici është kandidat i Partisë Socialiste për kryetar në Bashkinë e Kukës dhe Partia Socialiste është një nga subjektet zgjedhore, të regjistruara në zgjedhjet e 14 majit 2023. Dhe për rrjedhojë, ky kusht i parë në lidhje me subjektin ndaj të cilit duhet të jenë vënë në mbështetje dhe prej të cilit janë përdorur burimet, plotësohet në rastin konkret.

7. *Përsa i takon kushtit të dytë të lidhur me vënien në dispozicion të burimeve publike, duhet që burimet të jenë asete të luajtshme ose të paluajtshme në pronësi të organeve publike qendrore ose të njësisive të vetëqeverisjes vendore. Në referim të nenit 142, të Kodit Civil, sende të paluajtshme janë toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat, ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën, kurse të gjitha sendet e tjera, përfshirë dhe çdo energji tjetër natyrore, janë sende të luajtshme.*

7.1 Siç rezulton edhe nga rrethanat e çështjes, veprimtaria publike është zhvilluar në ambientet e oborrit të shkollës 9-vjeçare “Isuf Seferi”, në fshatin Fshat, të Njesisë Administrative Grykë-Çajë. Përsa më sipër, në rastin konkret, provohet tërësisht përmbushja e këtij kushti të dytë.

8. *Përsa i takon kushtit të tretë që lidhet me qëllimin e vënies në dispozicion të aseteve publike, referuar pikës 2, të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, për efekt të ngarkimit me përgjegjësi administrative duhet që vënia në dispozicion e aseteve shtetërore e publike të jetë bërë për qëllime zgjedhore.*

8.1 Në rastin konkret, është e qartë që vënia në dispozicion e aseteve shtetërore është bërë për qëllime zgjedhore. Kjo vërehet, së pari, nga vendosja e banderolave dhe materialeve të tjera propaganduese të Partisë Socialiste, duke përfshirë dhe sloganin “Kurrë më mbrapa, vetëm përpara”. Njëherazi, edhe deklaratimet e Znj. Bici, e cila shprehet se: *“Në qoftë se votat tuaja do jenë për Partinë Socialiste dhe për kryetarin e palodhur, Safetin, edhe investimet do të jenë më të mëdhaja”*. Përpos këtyre deklaratave, Znj. Bici, Drejtor i Përgjithshëm i ASHK-së, është shprehur se *“Prandaj të gjithë bashkë të punojmë, t’i japim krahun njeriut të punës, t’i japim krahun njeriut më të mirë, jo për të fituar, se është e sigurt, por për të patur një fitore të sigurt”*.

9. Gjithashtu, në referim të pikës 2, të nenit 3, të vendimit nr. 9/2020, mbi një kategori të caktuar të funksionarëve publikë rëndon detyrimi që gjatë periudhës kohore katër mujore para





datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdo forme, në veprimtari të ndaluara. Në këtë kategori të funksionarëve publikë bëjnë pjesë dhe drejtorët e përgjithshëm të agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrit. Në referim të nenit 6, të nenit 118/2020 “Për kadastrën”, Agjencia Shtetërore e Kadastrës është person juridik publik në varësi të Kryeministrit. Dhe për rrjedhojë, Drejtori i Përgjithshëm i Kadastrës, Znj. Dallëndyshe Bici ndalohet të marrë pjesë në të tilla aktivitete të ndaluara. Në të tilla kushte, përveç Z. Gjici dhe Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare të fshatit Fshat dhe personave të tjerë përgjegjës, Znj. Bici është përgjegjëse për shkeljen e kryer dhe duhet ndëshkuar me gjobë.

*B. Në lidhje me shkeljen e detyrimit për raportimin e veprimtarisë publike:*

**10.** Referuar pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, institucionet publike, qendrore dhe vendore, janë të detyruara të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të gjitha veprimtari të me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Në zbatim të pikës 2, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor dhe pikës 3, të nenit 4, të Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, raportimi në ndërfaqe duhet të kryhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara datës në të cilën planifikohet të zhvillohet. Në të kundërt, nëse veprimtaria publike nuk raportohet apo raportohet në tejkalim të këtij afati, do të ndodhemi përballë një shkeljeje administrative, e cila, në referim të pikës 6, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, e ngarkon personin përgjegjës për raportim me përgjegjësi administrative.

**11.** Sipas pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, veprimtari publike formojnë të gjitha ato veprimtari që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, Nga leximi i kësaj dispozite, rezulton se ndodhemi përballë detyrimit për raportim të një aktiviteti publik vetëm nëse plotësohen kushtet, të cilat për efekt të analizës së ligjit, duhet t’i ndajmë në kushte që lidhen me: (i) natyrën e veprimtarisë; (ii) subjektet që duhet ta kryejnë këtë veprimtari dhe (iii) afatin kohor brenda të të cilit ekziston detyrimi për raportim.

**12.** *Përsa u takon kushteve që lidhen me natyrën e veprimtarisë*, vlen të theksojmë se detyrimi për raportim ekziston për të gjitha ato veprimtari që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin. Pra për t’u ndodhur përballë detyrimit për të raportuar një aktivitet, ky i fundit duhet të: (i) ose të jetë i hapur për pjesëmarrjen e publikut apo medias; (ii) ose të ketë si agjendë të tij informimin. Sipas praktikës së Komisionit të Ankimit dhe Sanksioneve, më konkretisht në referim të vendimit nr. 19, datë 31.05.2022 dhe vendimit nr. 23, datë 14.09.2022, që veprimtaria të quhet publike, sipas kuptimit të kësaj dispozite, ajo nuk duhet domosdoshmërisht të jetë miting, tubim, mbledhje apo grumbullim i thirrur dhe i organizuar me synim pjesëmarrjen e publikut. Mjafton që ajo të jetë e “hapur”, domethënë të mos zhvillohet “pas dyerve të mbyllura”. Nuk ka nevojë që publiku apo media të thirren, të ftohen apo të mobilizohen për të marrë pjesë në veprimtari që ajo të quhet publike. Mjafton që ata të kenë



akses dhe të mos ndalohen kur i qasen asaj. Nga ana tjetër, veprimtaria bëhet publike sipas kuptimit të kësaj dispozite, edhe në rastet kur ajo zhvillohet “pas dyerve të mbyllura”, por ama synon dhe realizon në fakt informimin e publikut për temat, diskutimet dhe përfundimet e agjendës së saj.

13. Në rastin konkret, siç vërtetohet dhe nga rrethanat e faktit, verifikohet ekzistenca e këtij kushti. Kjo pasi takimi ka qenë i hapur për publikun dhe është pasqyruar gjerësisht në rrjetet sociale.

14. *Përsa u takon subjekteve që duhet ta kryejnë veprimtarinë publike mbi të cilën rëndon detyrimi për raportim*, në referim të pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, përcaktohet se detyrimi për raportim ekziston mbi institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore. Në rastin konkret, mbi veprimtarinë në fjalë ka rënduar detyrimi për raportim dhe për rrjedhojë, edhe kushti i dytë plotësohet.

15. *Përsa i takon afatit kohor për veprimtarinë publike, të cilat duhet të raportohen*, në referim të fjalisë së dytë, të pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, detyrimi për raportim ekziston për të gjithë ato veprimtari publike që bëhen brenda një periudhe 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve. Për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, periudha 4 (katër) mujore, brenda të cilës ekziston detyrimi për raportim i aktiviteteve publike, ka filluar më datë 13 janar 2023. Ndërkohë që, veprimtaria publike në ambientet e Spitalit Rajonal të Lezhës është zhvilluar brenda kësaj periudhe. Megjithë këtë detyrim ligjor që buron për institucionin përgjegjës për të raportuar aktivitetin në fjalë, siç rezulton nga provat bashkëlidhur këtij kallëzimi, Z. Korbi, në cilësinë e personit të ngarkuar me detyrimin për raportim nuk ka ndërmarrë asnjë masë për raportimin e këtij aktiviteti në ndërfaqen e krijuar dhe administruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe për rrjedhojë, subjekti përgjegjës duhet sanksionuar administrativisht sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe të Vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9/2020.

#### **IV. KONKLUZIONE:**

16. Përsa më lart, mbështetur në nenin pikën 1 dhe 2, të nenit 91, në pikën 1, të nenit 171 dhe në pikën 1, të nenit 172, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë; pikën 1 dhe 2, të nenit 3 dhe pikën 1, të nenit 10, të Vendimit të Komisionit Rregullator nr. 9/2020, përfundimisht,

#### **KËRKOJMË:**

1. Konstatimin e përdorimit të burimeve publike.
2. Konstatimin e shkeljes së detyrimit për të raportuar veprimtarinë publike.
3. Marrjen e sanksioneve administrative bazuar në dispozitat ligjore ndaj Z. Safet Gjici, Z. Dëfrim Korbi, Znj. Dallëndyshe Bici dhe ndaj çdo personi tjetër përgjegjës.



Për "QËNDRESA QYTETARE"



Rigels XHEMOLLARI


**Bashkëlidhur mund të gjeni:**

- Prova nr. 1 – Fotografi të shkëputura nga postimi i Z. Gjici;
- Prova nr. 2 – Ndërfaqja e raportimeve e Bashkisë Kukës;
- Prova nr. 3 – Ndërfaqja e raportimeve e Agjencisë Shtetërore e Kadastrës.









TAKIM NË FSHATIN FSHAT

#UNËVOTOJ PUNËN  
#UNËVOTOJSAFETGJICI





TAKIM NË FSHATIN FSHAT


#UNËVOTOJ PUNËN  
#UNËVOTOJSAFETGJICI

DPS

PERPARA















FAQJA KRYESORE | AKTIVITETET E RAPORTUARA | AKTIVITETE TË NDALUARA | HVR

Inspektim në Tënderine, Njësia Ujmisht

Bashkia Kukës | 24/03/23 | Aktivitetet e raportuara

Inspektimi për të parë punimet e rrugës Lloji i Aktivitetit: Inspektim/Kontrolli Data: 30/03/2023 Ora: 10:00 Vendi i Zhvillimit: Tënderine, Ujmisht Shteti: Shqipëri Qarku: Kukës Bashkia: Kukës Njësia Administrative: Ujmisht Fjalësit kryesorë:: Sifat GjigProzicioni...

Inspektim në Tënderine

Bashkia Kukës | 24/03/23 | Aktivitetet e raportuara

Inspektimi për të parë securinë e punimeve në hapjen e kanalizimere Lloji i Aktivitetit: Inspektim/Kontrolli Data: 29/03/2023 Ora: 10:00 Vendi i Zhvillimit: Lagje e Re Shteti: Shqipëri Qarku: Kukës Bashkia: Kukës Njësia Administrative: Kukës Fjalësit kryesorë:: Sifat...

**Akses i Lehtësuar**

**Legjislacioni**

 **Konstitucija**

 **Kodi Zgjedhor**

 **Ujfi për partitë politike**

 **Ujfi dekrimalizimit**



**Transparenca**

**Koordinatori**

**Programi**

**Modellet**

**Informacione**

**Ripëstat Sociale**


  











**TAKIM NË FSHATIN FSHAT**

**#UNËVOTOJPUNËN  
#UNËVOTOJSAFETGJICI**



**Kerkese per informacion, bashkia Kukes (335)**

ZVA Kukes &lt;ZVAKukes@arsimi.gov.al&gt;

Thu 4/27/2023 1:39 PM

To: denoncime &lt;denoncime@kqz.gov.al&gt;

Pershendetje ,

Zyra e Arsimit Parauniversitar Kukes , nuk ka dijeni per zhvillimin e nje takimi te tille ne ambientet e shkolles 9-vjeçare Fshat .

Ankesa ju dergua dhe drejtorit te shkolles z.Betim Lushi( ne pritje te pergjigjes se tij) .

Theksojme faktin se keto shkolla , jane pa nje rrethim te ambienteve te jashtme , dhe nuk jane te paisura me roje nga shteti , ose me vetefinancim nga prinderit e kesaj shkolle.

Pune te mbare !

---

**From:** denoncime <denoncime@kqz.gov.al>**Sent:** Wednesday, April 26, 2023 2:57 PM**To:** ZVA Kukes <ZVAKukes@arsimi.gov.al>**Subject:** Fw: Kerkese per informacion, bashkia Kukes (335)

Pershendetje,

Ju bejme me dije se kemi administruar denoncimin sipas shkresës nr. 3946, datë 19.04.2023 , i përcjellë nga Organizata "Qëndresa Qytetare" nëpërmjet së cilit pretendohet si vijon:

*"Më datë 16 prill 2023, në ambientet e oborrit të shkollës 9-vjeçare*

*"Isuf Seferi", në fshatin Fshat, të Njësisë Administrative Grykë-*

*Çajë, është zhvilluar një takim mes kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Kukësit, njëherazi dhe kryetar aktual i kësaj Bashkie,*

*Z. Safet Gjici dhe banorëve të fshatit Fshat, të Njësisë Administrative. Siç rezulton nga pamjet filmike,*

*z. Gjici ka qenë i shoqëruar nga Znj. Dallëndyshe Bici, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në ndërfaqen e raportimeve, nuk rezulton që aktiviteti në fjalë të jetë raportuar nga Bashkia e Kukësit . Po a shtu, aktiviteti nuk rezulton të jetë raportuar as nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.*

*Gjatë këtij takimi, ndër të tjera, Dallandyshe Bici, fjala e së cilës pasqyrohet në minutat 1:23-*

*2:17, të videos, të publikuar, shprehet: "Kështu në qoftë se votat tuaja do jenë për Partinë Socialiste dhe për kryetarim e palodhur, Safetin, edhe investimet do të jenë më të mëdhaja. Prandaj të gjithë bashkë të punojmë, t'i japim krahun njeriut të punës, t'i japim krahun njeriut më të mirë, jo për të fituar,*

*se është e sigurt, por për të patur një fitore të sigurt. Sipas denoncimit te*

*pretenduar të mbërritura në adresën e Qendrës "Qëndresa Qytetare", dhe siç verifikohet lehtësisht, aktiviteti është zhvilluar në ambientet e shkollës 9-vjeçare "Isuf Seferi", ne fshatin Fshat".*

Per sa me siper kerkojme informacion te detajuar nga ana juaj nne lidhje me sa me siper denoncohet, Ju lutem emaili te percillet menjehere per informacion dhe prane Drejtorit te shkolle.

Pretendimet tuaja dhe te drejtorit te shkolles te vendosen ne dispozicion te KQZ-se nepermjet kesaj adrese emaili brenda dates 27.04.2023.





**Kerkese per informacion, bashkia Kukes (335)**

ZVA Kukes &lt;ZVAKukes@arsimi.gov.al&gt;

Thu 4/27/2023 1:39 PM

To: denoncime &lt;denoncime@kqz.gov.al&gt;

Pershendetje ,

Zyra e Arsimit Parauniversitar Kukes , nuk ka dijeni per zhvillimin e nje takimi te tille ne ambientet e shkolles 9-vjeçare Fshat .

Ankesa ju dergua dhe drejtorit te shkolles z.Betim Lushi( ne pritje te pergjigjes se tij) .

Theksojme faktin se keto shkolla , jane pa nje rrethim te ambienteve te jashtme , dhe nuk jane te paisura me roje nga shteti , ose me vetefinancim nga prinderit e kesaj shkolle.

Pune te mbare !

---

**From:** denoncime <denoncime@kqz.gov.al>**Sent:** Wednesday, April 26, 2023 2:57 PM**To:** ZVA Kukes <ZVAKukes@arsimi.gov.al>**Subject:** Fw: Kerkese per informacion, bashkia Kukes (335)

Pershendetje,

Ju bejme me dije se kemi administruar denoncimin sipas shkresës nr. 3946, datë 19.04.2023 , i përcjellë nga Organizata "Qëndresa Qytetare" nëpërmjet së cilit pretendohet si vijon:

*"Më datë 16 prill 2023, në ambientet e oborrit të shkollës 9-vjeçare*

*"Isuf Seferi", në fshatin Fshat, të Njësisë Administrative Grykë-*

*Çajë, është zhvilluar një takim mes kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Kukësit, njëherazi dhe kryetar aktual i kësaj Bashkie,*

*Z. Safet Gjici dhe banorëve të fshatit Fshat, të Njësisë Administrative. Siç rezulton nga pamjet filmike,*

*z. Gjici ka qenë i shoqëruar nga Znj. Dallëndyshe Bici, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në ndërfaqen e raportimeve, nuk rezulton që aktiviteti në fjalë të jetë raportuar nga Bashkia e Kukësit . Po a shtu, aktiviteti nuk rezulton të jetë raportuar as nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.*

*Gjatë këtij takimi, ndër të tjera, Dallandyshe Bici, fjala e së cilës pasqyrohet në minutat 1:23-*

*2:17, të videos, të publikuar, shprehet: "Kështu në qoftë se votat tuaja do jenë për Partinë Socialiste dhe për kryetarin e palodhur, Safetin, edhe investimet do të jenë më të mëdhaja. Prandaj të gjithë bashkë të punojmë, t'i japim krahun njeriut të punës, t'i japim krahun njeriut më të mirë, jo për të fituar,*

*se është e sigurt, por për të patur një fitore të sigurt. Sipas denoncimit te*

*pretenduar të mbërritura në adresën e Qendrës "Qëndresa Qytetare", dhe siç verifikohet lehtësisht, aktiviteti është zhvilluar në ambientet e shkollës 9-vjeçare "Isuf Seferi", ne fshatin Fshat".*

Per sa me siper kerkojme informacion te detajuar nga ana juaj nne lidhje me sa me siper denoncohet, Ju lutem emaili te percillet menjehere per informacion dhe prane Drejtorit te shkolle.

Pretendimet tuaja dhe te drejtorit te shkolles te vendosen ne dispozicion te KQZ-se nepermjet kesaj adrese emaili brenda dates 27.04.2023.





## Kerkese per informacion, bashkia Kukës (335)

denoncime <denoncime@kqz.gov.al>

Thu 4/20/2023 3:31 PM

To: Ledia Lila <ledia.lila@ashk.gov.al>; Defrim Korbi <defrim.korbi@gmail.com>

Cc: Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com>

Bcc: Ylli Merkaj <Ylli.Merkaj@kqz.gov.al>; Aurel Lamce <Aurel.Lamce@kqz.gov.al>; Madalena Koja <Madalena.Koja@kqz.gov.al>

Pershendetje,

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 3946, datë 19.04.2023, është administruar denoncimi i përcjellë nga Organizata "Qëndresa Qytetare" nëpërmjet së cilit pretendohet si vijon:

*"Më datë 16 prill 2023, në ambientet e oborrit të shkollës 9-vjeçare "Isuf Seferi", në fshatin Fshat, të Njësisë Administrative Grykë-Çajë, është zhvilluar një takim mes kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Kukësit, njëherazi dhe kryetar aktual i kësaj Bashkie, Z. Safet Gjici dhe banorëve të fshatit Fshat, të Njësisë Administrative. Siç rezulton nga pamjet filmike, z. Gjici ka qenë i shoqëruar nga Znj. Dallëndyshe Bici, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në ndërfaqen e raportimeve, nuk rezulton që aktiviteti në fjalë të jetë raportuar nga Bashkia e Kukësit. Po ashtu, aktiviteti nuk rezulton të jetë raportuar as nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Gjatë këtij takimi, ndër të tjera, Dallandyshe Bici, fjala e së cilës pasqyrohet në minutat 1:23-2:17, të videos, të publikuar, shprehet: "Kështu në qoftë se votat tuaja do jenë për Partinë Socialiste dhe për kryetarin e palodhur, Safetin, edhe investimet do të jenë më të mëdhaja. Prandaj të gjithë bashkë të punojmë, t'i japim krahun njeriut të punës, t'i japim krahun njeriut më të mirë, jo për të fituar, se është e sigurt, por për të patur një fitore të sigurt. Sipas denoncimit te pretenduar të mbërritura në adresën e Qendrës "Qëndresa Qytetare", dhe siç verifikohet lehtësisht, aktiviteti është zhvilluar në ambientet e shkollës 9-vjeçare "Isuf Seferi", në fshatin Fshat".*

Per sa me siper kerkojme informacion te detajuar nga ana juaj ne lidhje me denoncimin e pretenduar nga deoncuesi, arsyen e mosraportimit te veprimtarise publike, si dhe arsyen e shperdorimit te burimeve publike.

Pretendimet tuaja duhet te percillen prane Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni e këtij email-i.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

